

1858
3.9-24

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DEPARTAMENTI I FINANCËS
DREJTORIA EKONOMIKE

Nr. 6004 Prot

Tiranë, më 23/08 2024

Lënda: Kërkesë për aplikim për Tarifën e Transmetimit të Energjisë Elektrike për periudhën rregullatore 2025-2027

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGISË
Adresa: Blvd. Bajram Curri, Rr. Viktor Eftemiu 1023

I nderuar Z. Ahmeti,

Në përputhje me (i) Ligjin nr. 43/2015 dt. 30.4.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, (ii) Metodologjinë e Llogaritjes së tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike, OST ka përgatitur “Përlllogaritjen e Tarifës për periudhën rregullatore 2025-2027”.

OST sh.a. në llogaritjen e tarifës së transmetimit për periudhën rregullatore 2025-2027, ka ndjekur me rigorozitet të drejtat dhe detyrat që ajo ka në referencë te ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenet 55, 56, 60, 61, 62, 65 dhe 66, si dhe neni 2 i “Metodologjia e Llogaritjes së Tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike”.

Në referencë të ligjit të sipërcituar, neni 55, pika 1, jeni të lutur që të merrni në shqyrtim dhe të konsideroni materialin tonë për aplikimin e tarifave të transmetimit të energjisë elektrike për OST për periudhën rregullatore 2025-2027.

Në mbështetje të kësaj kërkesë, bashkëlidhur do të gjeni:

- *Relacioni sqarues për llogaritjen e tarifës;*
- *Raporti i Ecurisë së Veprimtarisë së OST sh.a., për periudhën Janar - Qershor 2024;*
- *Plani i Investimeve i shoqërisë OST sh.a. për periudhën rregullatore 2022-2024 dhe 2025-2027;*
- *Gjëndja e Huave Afatgjata të OST sh.a., dhe kostot e tyre për periudhën 2025-2027;*
- *Lista e llogarive të OST sh.a..*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, jemi në dispozicionin Tuaj për çdo sqarim dhe informacion të nevojshëm.

Me respekt,

ADMINISTRATORI I OST sh.a.
Skërdi Dreneva
OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT



RELACION

PËR LLOGARITJEN

E TARËS SË TRANSMETIMIT

TË ENERGISË

ELEKTRIKE

PËR PERIUDHËN RREGULLATORE

2025-2027

Përmbajtja

I.	Informacion i përgjithshëm rreth OST sh.a.....	2
II.	Qëllimi i propozimit për rishikimin e tarifës së transmetimit.	3
III.	Raport i aktivitetit të OST sh.a. për Periudhën Janar-Qershor 2024 dhe pritshmëria për vitin 2024.....	3
IV.	Parashikimi i kërkesës për periudhën 2025-2027	5
V.	Llogaritja e tarifave të transmetimit për periudhën 2025-2027	8
	<i>A. Kostot kapitale</i>	<i>9</i>
VI.	Parshikimi i Investimeve për periudhën 2025-2027.....	9
	<i>B. Kostot operuese.....</i>	<i>11</i>
	<i>C. Të ardhurat nga aktivitete të tjera</i>	<i>16</i>
VII.	Tarifa aktuale – Periudha rregullatore 2022-2024	17
VIII.	Llogaritja e Tarifave – Periudha Rregullatore 2025-2027	19
VIII.1	Llogaritja e Tarifës me një nivel – Norma e WACC 2.28%	20
VIII.2	Llogaritja e Tarifës me një nivel – Norma e WACC 4.81%	21
IX.	Vleresimet e Tarifës së Transmetimit për përdorim të rrjetit të transmetimit....	22
X.	Konkluzionet dhe efektet.....	24

I. Informacion i përgjithshëm rreth OST sh.a.

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike në Shqipëri drejtohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. ('Shoqëria'), një Shoqëri publike me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit. Shoqëria u krijua në Korrik të vitit 2004 bazuar në Vendimin nr. 797 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, datë 4 dhjetor 2003. Në bazë të këtij vendimi Shoqëria u themelua si rezultat i ndarjes nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare Sh. a ("KESH") me kapitali fillestar prej 2,000 mijë Lekë. Ndarja nga KESH u krye bazuar në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 30 qershor 2006. Shoqëria përgatiti pasqyra financiare si një njësi ekonomike e veçantë duke filluar prej 1 korrik 2006 dhe jo prej vitit 2004 kur nisën të kryheshin transaksionet e para të Shoqërisë. Në vitin 2006 Shoqëria mori licencën për transmetim energjie nga Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri dhe në vijim nënshkroi një marrëveshje për shërbime transmetimi me KESH Bazuar në urdhrin nr. 329 të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes ('Ministria') datë 9 maj 2008, pronësia e OST iu transferua Ministrisë. Me anë të urdherit numer 10540/17 të Ministrisë, Shoqëria, prej datës 1 janar 2008 filloi të faturonte shërbimet e saj, aktivitetet e cili me parë kryhej nepërmjet KESH.

Shoqëria aktualisht e ushtron aktivitetin e saj nepërmjet 6 Njësive Operative (me qendër në Shkodër, Burrel, Tiranë, Elbasan, Fier, Korçë), Njësia e Mirëmbajtjes së Transmetimit (me qendër në Tiranë) dhe Administrata Qëndrore e cila është edhe selia e shoqërisë me adresë Autostrada Tiranë – Durrës, Km 9 Yrshek Kashar, Tiranë, Shqipëri.

Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi OST sh.a. ka përgjegjësinë të operojë, të mirëmbajë dhe të zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkonjeksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike. OST, është një nga pjesëtarët kryesorë të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.

Me Vendimin nr. 12 datë 08.09.2020, Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a., si dhe me Vendimin nr. 130 datë 05.10.2020, Asambleja e Përgjithshme e OST sh.a. – Ministria e Financave dhe Ekonomisë, miratuan pjesëmarrjen e OST sh.a., si aksionare në Shoqërinë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., me 57.25% të kapitalit themeltar; si dhe Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., të cilat do të nënshkruheshin nga OST sh.a. dhe KOSTT sh.a.

Në datën 05 Tetor 2020, përfaqësuesit ligjorë të OST sh.a. dhe KOSTT sh.a., firmosën Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a.- ALPEX.

Shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a.- ALPEX, operon në menaxhimin dhe administrimin e tregut të organizuar të energjise elektrike, nëpërmjet platformës së tregut në bazë të ditës në avancë.

II. Qëllimi i propozimit për rishikimin e tarifës së transmetimit.

Ky aplikim, ka për qëllim të pasqyrojë nevojën për rishikimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, tarifë e cila do të bëjë të mundur ushtrimin e aktivitetit normal të Operatorit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.

Tarifa e transmetimit të energjisë elektrike synon të mbledhë të ardhurat e nevojshme për të zhvilluar investimet e nevojshme në sistem, për të mbuluar kostot operative të drejtimit të shoqërisë si dhe për të minimizuar humbjet në rrjetin e transmetimit.

Tarifa e transmetimit synon të shlyejë kostot e aktiviteteve të mëposhtme:

- a) Pronësinë, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjave, kabllave, nënstacioneve, transformatoreve, qëndrave dispeçer dhe ndërtesave që lidhen me to si dhe facilitetet e komunikimit.
- b) Kostot e rezervave operuese të OST-së që nevojiten për të siguruar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemit të transmetimit.
- c) Kostot e shërbimeve të tjera ndihmëse të OST-së, përfshirë pagesat e bëra OST-ve fqinje për të siguruar energji elektrike emergjente dhe rezerva të çastit dhe pagesat (nëse ka) për frekuencën dhe rregullimin e tensionit.
- d) Kostot e kompensimit të energjisë reaktive, që duhen alokuar në një pagesë për energjinë reaktive.
- e) Kostot për të siguruar zyra, komunikim dhe facilitete të Teknologjisë së Informacionit (IT) për Operatorin e Tregut plus kostot e personeli që lidhen me Operatorin e Tregut. Nga këndvështrimi kontabël Operatori i Tregut duhet të këtë llogaritë e tij, sikur të ishte një njësi ligjore e pavarur me të ardhura të tatueshme më vete.
- f) Pagesat e detyrimeve që vijnë nga të gjitha huatë e marra për zhvillimin e rrjetit të transmetimit.
- g) Do të mbulojë kostot e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit si dhe sigurimin e shërbimeve ndihmëse e të balancimit të prokuruar në treg.

III. Raport i aktivitetit të OST sh.a. për Periudhën Janar-Qershor 2024 dhe pritshmëria për vitin 2024

Referuar Programit të Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a., për vitin 2024, të miratuar së pari me Vendimin Nr. 17, datë 14.12.2023 të Këshillit Mbikëqyrës së OST sh.a., si dhe miratuar me shkresën Nr. 716/1, datë 06.02.2024 të MEKI, OST sh.a. ka vijuar ushtrimin e aktivitetit të vet në funksion të plotësimin e kushteve të sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike. Raporti i Ecurisë së Veprimtarisë së OST sh.a., për periudhën Janar - Qershor 2024, gjendet Raport më vete, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali.

Gjatë ecurisë së aktivitetit të OST sh.a., për realizimin e objektivave dhe treguesëve kryesorë të kompanisë, duke marrë në konsideratë realizimin e treguesve ekonomiko-financiar gjatë periudhës Janar-Qershor 2024 si dhe parashikimet më të përditësuara për periudhën e mbetur

të vitit 2024, nga ana e OST sh.a. është bërë një analizë në lidhje me prioritetet dhe efektivitetin e fondeve të programuara më parë për vitin 2024.

Në tabelën e mëposhtme, pasqyrohet rezultati financiar i pritshëm për vitin 2024.


Emertimi	Njesia Matese	Viti 2023	Viti 2024		
			6 Majori I Fakt	6 Majori II Plan	I Pritshmi
Energjia Totale që hyn në sistemin e OST	<i>GWh</i>	10,147	5,134	5,162	10,296
<i>Prodhim vendas</i>	"	8,226	3,976	3,731	7,707
<i>Energji në marrje</i>	"	1,922	1,158	1,431	2,589
Energjia totale e transmetuar	<i>GWh</i>	9,927	5,029	5,052	10,081
<i>Energji elektrike e dhënë</i>	"	2,842	1,480	1,179	2,658
<i>Energji elektrike për OSHEE sh.a.</i>	"	6,492	3,246	3,542	6,788
<i>Energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar</i>	"	594	303	332	635
Humbjet në rrjetin e transmetimit	<i>GWh</i>				
<i>Humbjet në GWh</i>	"	220	105	110	214
<i>Humbjet në %</i>	%	2.17%	2.04%	2.12%	2.08%
Investimet gjithsej	<i>Mln/Lekë</i>	3,435	1,968	5,677	7,664
Nga këto:					
Sipas burimeve të financimit	<i>Mln/Lekë</i>				
<i>Burimet e veta</i>	"	2,041	869	2,771	3,641
<i>Ndihmë dhe kredi e huaj</i>	"	1,393	1,098	2,925	4,023
Treguesit e punës					
<i>Punonjës gjithsej</i>	<i>Nr. mesatar</i>	756	752	756	792
<i>Fondi i pagave gjithsej</i>	<i>Mln/Lekë</i>	741	396	463	859
<i>Paga mesatare</i>	<i>Lekë</i>	81,707	87,806	101,962	90,349
Sasia e transmetuar (OSHEE+FurnizuesKualifikuar)	<i>GWh</i>	7,086	3,550	3,980	7,530
Humbjet	<i>GWh</i>	220	105	110	214
Sherbimet Ndihmese (aFRR+ & aFRR-)	<i>MW/h</i>	268,160	58,085	202,659	260,745
Cmimi i Humbjeve	<i>EUR/MWh</i>	91.7	94.8	94.8	91.7
Cmimi i Sherbimeve ndihmese	<i>EUR/MWh</i>	28.9	39.2	42.0	41.3
TE ARDHURAT					
<i>Transmetimi i energjise</i>	<i>mln Leke</i>	6,044	3,022	3,383	6,405
<i>Alokimi i kapaciteteve</i>	<i>mln Leke</i>	2,508	877	1,229	2,106
<i>Të ardhura nga telekomunikacioni</i>	<i>mln Leke</i>	40	5	30	35
<i>Disbalancat</i>	<i>mln Leke</i>	1,313	763	0	763
<i>Te Ardhura te Tjera</i>	<i>mln Leke</i>	5,371	803	18	821
<i>Te Ardhura nga grantet</i>	<i>mln Leke</i>	96	48	25	73
Totali te Ardhura	<i>mln Leke</i>	15,372	5,519	4,684	10,203
SHPENZIMET					
<i>Blerja e humbjeve</i>	<i>mln Leke</i>	2,124	840	1,100	1,940
<i>Blerja e sherbimeve ndihmese</i>	<i>mln Leke</i>	806	233	868	1,101
<i>Menaxhimi i kongjestionit me ridispecim</i>	<i>mln Leke</i>				0
<i>Pagesë ITC</i>	<i>mln Leke</i>	378	189	125	314
<i>Materiale të para</i>	<i>mln Leke</i>	103	36	82	119
<i>Personeli</i>	<i>mln Leke</i>	1,201	680	839	1,519
<i>Furnitoret dhe Sherbimet (Te tjere)</i>	<i>mln Leke</i>	1,086	362	402	764
<i>Amortizimi</i>	<i>mln Leke</i>	2,563	1,268	1,265	2,534
Totali i Shpenzimeve Operative	<i>mln Leke</i>	8,261	3,608	4,682	8,290
Interesa	<i>mln Leke</i>	889	226	264	489
Fitimi/Humbja para tatimeve	<i>mln Leke</i>	6,222	1,685	-261	1,424
Tatim Fitimi	<i>mln Leke</i>	652	254	0	254
Fitimi/Humbja Neto	<i>mln Leke</i>	5,570	1,431	-261	1,170
EBTDA	<i>mln Leke</i>	8,785	2,953	1,004	3,958

IV. Parashikimi i kërkesës për periudhën 2025-2027

Mbi bazën e të dhënave historike për dhjetë vitet e fundit te konsumit mesatar ditor per cdo muaj, rezulton se gradienti mesatar i rritjes së kërkesës për energji elektrike, që transmetohet nëpërmjet rrjetit për OSSH dhe konsumatorët e lidhur në rrjetin e transmetimit është rreth 0.29%, sic paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Viti / muaji →	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
2012	24,358	23,940	19,626	19,506	17,487	18,138	19,581	19,895	18,449	17,861	20,088	25,252	
2013	25,170	24,999	22,871	19,289	17,938	18,928	19,673	19,731	18,267	18,790	21,346	26,372	
2014	24,686	23,420	21,833	20,182	18,152	18,023	18,657	19,991	18,502	19,512	20,195	22,104	
2015	22,173	20,912	19,248	16,710	16,558	16,893	18,766	19,010	17,174	15,677	17,955	21,512	
2016	21,616	18,688	18,121	15,897	16,016	15,722	17,443	17,847	16,270	16,458	18,600	23,104	
2017	24,259	20,737	18,514	17,819	16,817	18,341	19,251	19,889	17,269	17,901	20,088	22,340	
2018	21,841	22,339	20,833	17,696	17,175	17,678	18,655	20,039	17,972	17,896	19,710	23,912	
2019	24,237	21,447	19,915	18,634	17,790	18,826	19,752	20,954	18,076	16,781	17,933	21,668	
2020	23,573	21,873	19,411	16,436	16,212	17,310	19,146	19,597	18,544	18,387	20,985	23,726	
2021	24,592	23,367	22,310	21,435	18,387	19,517	21,981	22,852	19,341	19,436	21,066	25,151	
2022	25,065	24,385	23,769	19,994	17,923	19,571	20,771	20,352	16,821	15,672	18,888	21,148	
2023	22,614	23,147	19,352	19,141	17,727	18,177	20,939	20,673	18,280	17,072	19,596	23,634	
2024	24,089	21,930	19,931	17,804	16,890	19,875	23,770						
Rritja 2012/2013	3.3%	4.4%	16.5%	-1.1%	2.6%	4.4%	0.5%	-0.8%	-1.0%	5.2%	6.3%	4.4%	Mesatare 3.7%
Rritja 2013/2014	-1.9%	-6.3%	-4.5%	4.6%	1.2%	-4.8%	-5.2%	1.3%	1.3%	3.8%	-5.4%	-16.2%	-2.7%
Rritja 2014/2015	-10.2%	-10.7%	-11.8%	-17.2%	-8.8%	-6.3%	0.6%	-4.9%	-7.2%	-19.7%	-11.1%	-2.7%	-9.2%
Rritja 2015/2016	-2.5%	-10.6%	-5.9%	-4.9%	-3.3%	-6.9%	-7.1%	-6.1%	-5.3%	5.0%	3.6%	7.4%	-3.0%
Rritja 2016/2017	12.2%	11.0%	2.2%	12.1%	5.0%	16.7%	10.4%	11.4%	6.1%	8.8%	8.0%	-3.3%	8.4%
Rritja 2017/2018	-10.0%	7.7%	12.5%	-0.7%	2.1%	-3.6%	-3.1%	0.8%	4.1%	0.0%	-1.9%	7.0%	1.2%
Rritja 2018/2019	11.0%	-4.0%	-4.4%	5.3%	3.6%	6.5%	5.9%	4.6%	0.6%	-6.2%	-9.0%	-9.4%	0.4%
Rritja 2019/2020	-2.7%	2.0%	-2.5%	-11.8%	-8.9%	-8.1%	-3.1%	-6.5%	2.6%	9.6%	17.0%	9.5%	-0.2%
Rritja 2020/2021	4.3%	6.8%	14.9%	30.4%	13.4%	12.7%	14.8%	16.6%	4.3%	5.7%	0.4%	6.0%	10.9%
Rritja 2021/2022	1.9%	4.4%	6.5%	-6.7%	-2.5%	0.3%	-5.5%	-10.9%	-13.0%	-19.4%	-10.3%	-15.9%	-5.9%
Rritja 2022/2023	-9.8%	-5.1%	-18.6%	-4.3%	-1.1%	-7.1%	0.8%	1.6%	8.7%	8.9%	3.7%	11.8%	-0.9%
Rritja 2023/2024	6.5%	-5.3%	3.0%	-7.0%	-4.7%	9.3%	13.5%						2.2%
Mesatare	0.2%	-0.5%	0.7%	-0.1%	-0.1%	1.1%	1.9%	0.6%	0.1%	0.2%	0.1%	-0.1%	0.3%
													Trend 0.29%

Konsumi mesatar ditor ne MWh




Duke pranuar që rritja e pritshme e volumit të energjisë elektrike që do të transmetohet nga OST per konsum, të jetë e rendit 0.29%, dhe duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të çdo muaji, është bërë parashikimi i konsumit të energjisë elektrike në rrejtin e transmetimit për vitin 2025, si në tabelën e mëposhtme:

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
Mujore	750	617	621	537	526	599	740	703	556	537	596	743	7,525
Mesatare ditore	MWh 24,198	MWh 22,029	MWh 20,021	MWh 17,884	MWh 16,966	MWh 19,965	MWh 23,877	MWh 22,678	MWh 18,546	MWh 17,320	MWh 19,881	MWh 23,978	
Ora / Ditë→	31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31	
1	MW 696	MW 647	MW 605	MW 576	MW 561	MW 667	MW 812	MW 776	MW 593	MW 536	MW 566	MW 686	
2	MW 605	MW 569	MW 541	MW 520	MW 513	MW 606	MW 736	MW 703	MW 553	MW 499	MW 515	MW 604	
3	MW 558	MW 529	MW 519	MW 491	MW 488	MW 575	MW 693	MW 659	MW 533	MW 495	MW 490	MW 563	
4	MW 541	MW 515	MW 553	MW 516	MW 480	MW 560	MW 669	MW 636	MW 525	MW 475	MW 484	MW 549	
5	MW 546	MW 525	MW 554	MW 530	MW 509	MW 564	MW 666	MW 632	MW 529	MW 482	MW 496	MW 560	
6	MW 605	MW 588	MW 586	MW 562	MW 544	MW 616	MW 685	MW 655	MW 564	MW 524	MW 552	MW 624	
7	MW 772	MW 761	MW 712	MW 653	MW 633	MW 697	MW 765	MW 731	MW 657	MW 634	MW 689	MW 788	
8	MW 1,014	MW 993	MW 878	MW 794	MW 749	MW 807	MW 884	MW 847	MW 785	MW 774	MW 858	MW 1,015	
9	MW 1,144	MW 1,074	MW 948	MW 857	MW 798	MW 876	MW 981	MW 931	MW 846	MW 823	MW 929	MW 1,136	
10	MW 1,172	MW 1,059	MW 948	MW 858	MW 800	MW 908	MW 1,061	MW 979	MW 859	MW 817	MW 940	MW 1,153	
11	MW 1,147	MW 1,008	MW 916	MW 840	MW 784	MW 917	MW 1,094	MW 1,002	MW 855	MW 799	MW 929	MW 1,119	
12	MW 1,121	MW 970	MW 896	MW 826	MW 779	MW 931	MW 1,125	MW 1,034	MW 859	MW 794	MW 925	MW 1,098	
13	MW 1,112	MW 958	MW 890	MW 815	MW 765	MW 920	MW 1,147	MW 1,059	MW 862	MW 789	MW 926	MW 1,096	
14	MW 1,131	MW 976	MW 908	MW 818	MW 769	MW 944	MW 1,168	MW 1,084	MW 870	MW 794	MW 936	MW 1,120	
15	MW 1,149	MW 996	MW 895	MW 803	MW 756	MW 931	MW 1,163	MW 1,081	MW 859	MW 789	MW 947	MW 1,146	
16	MW 1,169	MW 1,012	MW 898	MW 770	MW 744	MW 923	MW 1,147	MW 1,077	MW 846	MW 784	MW 959	MW 1,176	
17	MW 1,233	MW 1,051	MW 923	MW 764	MW 734	MW 930	MW 1,148	MW 1,083	MW 857	MW 800	MW 1,024	MW 1,262	
18	MW 1,347	MW 1,183	MW 1,008	MW 796	MW 754	MW 941	MW 1,156	MW 1,116	MW 893	MW 855	MW 1,104	MW 1,338	
19	MW 1,371	MW 1,269	MW 1,099	MW 849	MW 793	MW 967	MW 1,175	MW 1,155	MW 936	MW 932	MW 1,098	MW 1,333	
20	MW 1,357	MW 1,265	MW 1,114	MW 920	MW 839	MW 982	MW 1,179	MW 1,165	MW 995	MW 941	MW 1,076	MW 1,315	
21	MW 1,321	MW 1,231	MW 1,083	MW 966	MW 907	MW 1,018	MW 1,203	MW 1,201	MW 961	MW 884	MW 1,029	MW 1,271	
22	MW 1,210	MW 1,120	MW 989	MW 900	MW 862	MW 1,012	MW 1,195	MW 1,148	MW 870	MW 797	MW 933	MW 1,170	
23	MW 1,036	MW 955	MW 851	MW 793	MW 761	MW 903	MW 1,085	MW 1,030	MW 771	MW 699	MW 805	MW 1,016	
24	MW 842	MW 774	MW 705	MW 666	MW 645	MW 770	MW 940	MW 896	MW 668	MW 604	MW 670	MW 838	
Σ	MWh 24,198	MWh 22,029	MWh 20,021	MWh 17,884	MWh 16,966	MWh 19,965	MWh 23,877	MWh 22,678	MWh 18,546	MWh 17,320	MWh 19,881	MWh 23,978	

Në total, pritet që konsumi bruto për vitin 2025 të jetë i rreth 7.5 TWh.

Në varësi të kushteve meteorologjike të vendit tonë, nevojat e konsumit të energjisë për vitin 2025 priten të mbuloohen nga burimet hidrike dhe fotovoltaike në vend.

Rritja potenciale e gjenerimit të burimeve fotovoltaike në sistemin e transmetimit pasqyrohet me poshtë. Për realizimin e këtij parashikimi, është përdorur softi PVGIS (https://re.jrc.ec.europa.eu/pvg_tools/en/).



Në rastin kur kushtet meteorologjike nuk janë të favorshme, nevoja për konsum do të plotësohet nga importi.

Bazuar në të dhënat historike, dhe duke konsideruar rritjen e mundshme të numrit dhe volumit të kërkesës së Konsumatorëve të Kualifikuar, prodhimin e PVE dhe PPE, si dhe sasinë e energjisë që nevojitet për të mbuluar humbjet në rrjetin e transmetimit, është plotësuar tabela e bilancit të energjisë për vitin 2025 si më poshtë:

Nr.	Emertimi	Njesia	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2025
I.	Energjia Totale që hyn në sistemin e OST	GWh	1,072	922	901	851	801	734	839	900	847	741	871	1,073	10,553
a)	Prodhim vendas	"	943	743	710	620	696	561	654	601	518	422	715	952	8,136
b)	Energji në marrje	"	129	179	191	231	105	173	185	299	328	319	156	120	2,417
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	1,046	901	882	832	785	719	822	882	831	726	851	1,047	10,325
a)	Energji elektrike e dhene	"	326	286	283	316	278	138	104	172	221	164	278	358	2,924
b)	Energji elektrike për OSHEE sh.a	"	682	582	546	454	440	515	649	643	546	506	526	645	6,734
c)	Energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar	"	38	33	53	62	67	66	69	67	64	57	47	44	666
III.	Humbjet në rrjetin e transmetimit														
a)	Humbjet në GWh	GWh	26	21	19	19	16	15	17	18	16	15	20	26	228
b)	Humbjet në %	%	2.42%	2.28%	2.11%	2.23%	2.00%	2.04%	2.03%	2.00%	1.89%	2.02%	2.30%	2.42%	2.16%

Me të njëjtën mënyrë llogaritjeje, pra bazuar në të dhënat historike, është bërë parashikimi i bilancit energjetik për vitet në vazhdim, si në tabelat e mëposhtme:

Nr.	Emertimi	Njesia	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2026
I.	Energjia Totale që hyn në sistemin e OST	GWh	1,085	933	914	866	816	739	843	910	857	750	884	1,088	10,684
a)	Prodhim vendas	"	959	759	730	642	721	587	683	628	540	441	730	969	8,388
b)	Energji në marrje	"	126	174	184	224	95	152	160	282	317	309	155	119	2,296
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	1,059	913	895	847	798	725	825	889	840	733	863	1,062	10,450
a)	Energji elektrike e dhene	"	342	301	297	332	292	145	109	180	232	172	292	376	3,070
b)	Energji elektrike për OSHEE sh.a	"	677	578	542	451	437	511	644	638	541	502	522	640	6,680
c)	Energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar	"	40	34	56	65	70	69	72	71	67	60	50	46	700
III.	Humbjet në rrjetin e transmetimit														
a)	Humbjet në GWh	GWh	26	20	19	18	17	14	17	21	17	16	21	26	234
b)	Humbjet në %	%	2.41%	2.12%	2.13%	2.13%	2.10%	1.89%	2.03%	2.33%	1.96%	2.10%	2.35%	2.42%	2.19%

Nr.	Emertimi	Njesia	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2027
I.	Energjia Totale që hyn në sistemin e OST	GWh	1,102	948	929	882	831	749	847	918	869	755	898	1,105	10,833
a)	Prodhim vendas	"	965	766	743	656	737	605	702	646	555	453	737	975	8,539
b)	Energji në marrje	"	137	182	186	226	94	144	145	272	314	302	161	130	2,294
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	1,073	925	908	864	813	732	829	896	851	741	876	1,078	10,585
a)	Energji elektrike e dhene	"	359	316	312	348	306	152	115	189	244	180	307	395	3,224
b)	Energji elektrike për OSHEE sh.a	"	671	573	537	447	433	507	638	633	537	498	517	635	6,627
c)	Energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar	"	42	36	58	68	74	72	76	74	71	63	52	49	735
III.	Humbjet në rrjetin e transmetimit														
a)	Humbjet në GWh	GWh	29	23	21	18	18	17	17	22	18	14	22	27	247
b)	Humbjet në %	%	2.65%	2.44%	2.30%	2.09%	2.18%	2.24%	2.05%	2.38%	2.04%	1.86%	2.46%	2.47%	2.28%

Tabela e mëposhtme pasqyron parashikimet e Bilancit të energjisë për vitet 2025-2027

Emertimi	Njesia matese	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Energjia Totale që hyn në sistemin e OST	GWh	9,547	10,147	10,296	10,553	10,684	10,833
<i>Prodhim vendas</i>	"	6,504	8,226	7,707	8,136	8,388	8,539
<i>Energji në marrje</i>	"	3,044	1,922	2,589	2,417	2,296	2,294
Energjia totale e transmetuar	GWh	9,347	9,927	10,081	10,325	10,450	10,585
<i>Energji elektrike e dhënë</i>	"	2,123	2,842	2,658	2,924	3,070	3,224
<i>Energji elektrike për OSHEE sh.a.</i>	"	6,546	6,492	6,788	6,734	6,680	6,627
<i>Energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar</i>	"	679	594	635	666	700	735
Humbjet në GWh	GWh	200	220	214	228	234	247
Humbjet në %	%	2.09%	2.17%	2.08%	2.16%	2.19%	2.28%
Konsumi	GWh	7,225	7,086	7,423	7,401	7,380	7,362

V. Llogaritja e tarifave të transmetimit për periudhën 2025-2027

Në përputhje me metodologjinë, OST sh.a. ka bërë perlllogaritjet për të ardhurat e kërkuara dhe kostot totale të cilat ajo do të perballojë gjatë gjithë periudhës 2025-2027.

Niveli i synuar i të ardhurave që kërkohe nga OST do të mbulojë të gjitha kostot e lejuara nga Metodologjia e Transmetimit të Energjisë Elektrike respektivisht kostot e kapitalit dhe kostot operative.

Në mënyrë të përmbledhur, mënyra e perlllogaritjes së tarifës mesatare të transmetimit paraqitet si vijon:

$P_{mesatare}$ Tarifa mesatare e Transmetimit, sipas formulës:

$$P_{mesatare} = \frac{C}{E}$$

C Kërkesa për të ardhura;

E Energjia totale në kWh që do të tregtohet në faturat e konsumatorit;

C Kërkesa për të ardhura, sipas formulës:

$$C = C_{kapitale} + C_{operuese}$$

$C_{kapitale}$ Kostot e kapitalit (investimet + kosto e borxhit);

$C_{operuese}$ Kostot Operative;

$C_{kapitale}$ Kostot e kapitalit (investimet + kosto e borxhit), sipas formulës:

$$C_{kapitale} = R + D$$

R Kthimi mbi bazën e rregulluar të aseteve;

D Amortizimi i aseteve;

R Kthimi mbi bazën e rregulluar të aseteve, sipas formulës:

$$R = B \times WACC$$

B Baza e rregulluar e Aseteve;

$WACC$ Norma e lejuar e kthimit të Asetetit të rregulluar, sipas formulës:

$$WACC = \left[ES \times \frac{ARoE}{1 - T} \right] + (DS \times CoD)$$

Në mënyrë më të detajuar, analiza e këtyre elementeve të tarifës, pasqyrohet si më poshtë vijon:

A. Kostot kapitale

Zhvillimi i rrjetit të transmetimit në përputhje me parashikimet afatgjata dhe me planet e zhvillimit të sektorit elektroenergjetik në tërësi është një nga funksionet themelore të OST dhe përbën një domosdoshmëri për kryerjen e funksioneve të saj.

Gjatë viteve të fundit janë kryer një seri studimesh të sistemit të transmetimit që kanë përcaktuar projektet kryesore të nevojshme për zhvillimin e tij. Disa nga këto projekte janë në fazë implementimi dhe të tjerë, për të cilët është siguruar financimi nga institucione financiare ndërkombëtare do të vihen në zbatim në një periudhë kohore të përcaktuar.

Programi i investimeve të OST për vitet 2025+2027 është fokusuar kryesisht në:


- Rehabilitimin e rrjetit të transmetimit nëpërmjet rikonstruksionit të linjave ekzistuese me normë të lartë amortizimi dhe me rëndësi për sigurinë e sistemit;
- Ndërtimin e linjave të reja unazore duke rritur sigurinë e furnizimit nëpërmjet plotësimit të kushtit të sigurisë statike;
- Rritjen e kapaciteteve akomoduese të rrjetit në funksion të mbështetjes së politikës së diversifikimit të burimeve të energjisë elektrike dhe lidhjen e centraleve të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë (BRE);
- Rehabilitimit dhe ndërtimit të linjave të reja të interkonjeksionit duke bërë të mundur rritjen e shkëmbimeve ndërkufitare, sigurinë dhe besueshmërinë e operimit të rrjetit si dhe të cilësisë së furnizimit me energji elektrike.

VI. Parshikimi i Investimeve për periudhën 2025-2027

Gjatë viteve 2025-2027, OST sh.a., parashikon të kryejë rreth 16 miliardë lekë investime, nga të cilat, rreth 27 % të financuara me fonde të huaja, ndërsa pjesa tjetër parashikohet të bëhet me fondet e OST sh.a..

Investimet 2025-2027 (mln lekë)

Ndihmë dhe
kredi e huaj
4,303.9
27%



Burimet e veta
11,725.0
73%

Në mënyrë të përmbledhur, programi i investimeve për këtë periudhë paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Sipas burimeve të financimit	Njesia	2025	2026	2027	2025-2027
Burimet e veta	Mln. Lekë	4,324.8	3,887.3	3,513.0	11,725.0
Ndihmë dhe kredi e huaj	Mln. Lekë	4,303.9	0.0	0.0	4,303.9
Totali i Investimeve	Mln. Lekë	8,628.6	3,887.3	3,513.0	16,028.8

Realizimi i Planit të Investimeve për periudhën 2022-2024 si dhe Plani i Investimeve për periudhën rregullatore 2025-2027, gjendet Raport më vete, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali.

Kostot Kapitale

Kostot kapitale të OST sh.a. sipas metodologjisë përlogariten:

$$C_{kapitale} = R + D$$

R Kthimi mbi bazën e rregulluar të aseteve

D Amortizimi i aseteve fikse dhe amortizimi i aseteve të tjera

$$R = B \times WACC$$

B Aseti Bazë i Rregulluar në fillim të vitit bazë të ciklit të vlerësimit të tarifave

WACC Norma e lejueshme e kthimit të Asetit Bazë të Rregulluar.

Llogaritja e Asetit Bazë të Rregulluar (B) në fillim të vitit bazë 2025 (Vlera në fund të vitit 2024) është kryer duke marrë për bazë vlerën e RAB të njohur nga ERE në fillim të periudhës rregullatore 2022-2024 si dhe duke shtuar kapitalizimin e të gjitha investimeve në proces të kryera gjatë periudhës 2022-2024 su dhe duke zbritur amortizimin për këtë periudhë.

Për vitin 2025 amortizimi i parashikuar pritet të jetë rreth 2,610 milionë lekë ndërsa Aseti Bazë i Rregulluar (RAB) në fillim të vitit 2025 është rreth 39,031 milion lekë.

Rezultatet e perlogaritjeve për vitet 2025-2027, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Viti	RAB në fillim të periudhës	Investimet	Amortizimi	RAB në fund të periudhës
2024	33,900	7,664	2,534	39,031
2025	39,031	8,629	2,610	45,050
2026	45,050	3,887	2,688	46,249
2027	46,249	3,513	2,769	46,993

Sipas metodologjisë norma e lejueshme e kthimit për Asetin Bazë të Rregulluar është:

$$WACC = \left[ES \times \frac{ARoE}{1 - T} \right] + (DS \times CoD)$$

ES	Objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB
T	Norma e taksës së korporatës (Tatim-fitimi)
ARoE	Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse
DS	Objektivi për raportin e borxhit në RAB
CoD	Kosto e borxhit
ARoE -	<i>Norma e lejueshme e kthimit mbi kapitalin duhet të vendoset nga rregullatori mbi bazen e nevojës së OST-se për të marrë fluksin e parave për shpenzime kapitale dhe shërbimin e borxhit duke gjykuar nga pasqyra e burimeve dhe përdorimit të fondeve në vitin bazë.</i>
CoD -	<i>Kosto e borxhit – norma mesatare e interesit mbi borxhin afatgjatë është përcaktuar si shuma e pagesave të interesit mbi borxhin afatgjatë gjatë vitit bazë, pjesëtuar me principlin total mbi borxhin afatgjatë (shuma totale e marrë borxh) në fillim të vitit bazë.</i>

Në përlllogaritjen e tarifave për periudhën 2025-2027, është marrë në konsideratë:

1. Versioni 1 - $WACC = 2.28\%$, vlerë e cila është përlllogaritur nga ERE në Vendimin Nr. 72, datë 13.04.2022;
2. Versioni 2 - $WACC = 4.81\%$, Norma korresponduese e WACC per nivelin e miratuar te tarifës

Gjëndja e Huave Afatgjata të OST sh.a., deri në fund të muajit Qershor 2024, si dhe vlerësimet për kostot e tyre për periudhën 2025-2027, gjenden aneks më vete, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali.

OST i përdor fondet e siguruara nga kreditë afatgjatë ekskluzivisht për investimet e reja kapitale.

Gjatë viteve të fundit OST është angazhuar kredi afatgjata për të financuar projekte madhore për zgjerimin dhe përmirësimin sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

B. Kostot operuese

$$C_{operuese} = C_{matje} + C_{mirëmbajtje} + C_{personeli} + C_{energjie} + C_{shërbime\ me\ të\ tretë} + C_{taksë}$$

C_{matjes}	kosto e matjes së energjisë elektrike dhe energjisë se lëvruar tek klientët e sistemit të transmetimit dhe kosto e faturimit dhe likuidimeve të llogarive me përdoruesit e sistemit të transmetimit. Këto kosto lidhen me kostot e shkaktuara nga klientët, por nuk përfshin koston e matjes së humbjeve të energjisë elektrike, konsumin e energjisë elektrike për qëllime teknologjike dhe eksportin, importin dhe fluksin e tranzitit. Kostot e matjes janë të përfshira në kostot e tjera operuese të OST sh.a., respektivisht në kostot e pagave dhe mirëmbajtjes;
$C_{mirëmbajtje}$	pjesë zëvendësimi, furnizime, mjete, lëndë djegëse dhe kosto të tjera mirëmbajtje;
$C_{personeli}$	pagat, sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe kostot (Të ndryshme nga taksat) të lidhura me programet në përfitim të të punësuarve;

- C energjië** kostot për mbulimin dhe prokurimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit, pagesa për blerjen e shërbimeve ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit, kostot e ridispecimit, kostot e ITC;
- C taksë** Komponenti që mundëson që rregullatori të tregojë qartë pjesën e tarifës që atribuohet taksave dhe prandaj është përtej kontrollit të rregullatorit. Komponenti takse të ardhurave të synuara të OST-se për vitin baze, nuk përfshin TVSH-ne dhe tatimin mbi fitimin.

Në llogaritjen e tarifës së transmetimit, kosto për humbjet janë llogaritur duke u bazuar në çmimet e tregut:

$$C_{humbje} = E_{humbje} \times Ph$$

- E humbje** humbjet e energjisë në rrjetin e transmetimit gjatë vitit bazë
- Ph** çmimi mesatar i energjisë elektrike që do të blihet në treg për mbulimin e humbjeve gjatë vitit bazë.

Per periudhën 2025-2027, kostot operative të parashikuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	Njësia	2024	2025	2026	2027
C Operuesë	Mln ALL	5,756.3	7,938.6	8,074.3	8,492.6
Energjia	Mln ALL	3,354.6	5,262.5	5,333.2	5,684.5
Blerja e humbjeve	'''	1,939.6	2,549.0	2,366.5	2,222.3
Blerja e shërbimeve ndihmëse	'''	1,101.2	1,759.5	1,947.3	2,377.4
Menaxhimi i kongjestionit me ridispecim	'''	-	654.0	719.4	784.8
Pagesë ITC (Inter TSO Compensation mechanism)	'''	313.8	300.0	300.0	300.0
Kosto shfrytëzimit	Mln ALL	2,401.7	2,676.1	2,741.2	2,808.1
Shpenzime Personeli	'''	1,519.4	1,689.8	1,736.2	1,784.0
Materiale të para	'''	118.5	166.6	168.8	171.2
Shërbime administrative e te tjera	'''	763.8	819.7	836.1	852.8

Në mënyrë të detajuar, kostot operative të parashikuara për vitin 2025, po i paraqesim si më poshte:

✓ **Shpenzimet e Personelit**

Shpenzimet e personelit janë parashikuar duke konsideruar historikun dhe ecurinë aktuale të zërave të kostove të personelit, në përputhje të plotë me strukturën e pagave dhe atë organizative të OST sh.a.. Në përputhje me strukturën aktuale të OST sh.a., për vitin 2025, numri i punonjësve të OST sh.a. është 817 persona dhe shpenzimet totale për personelin janë parashikuar 1,689.8 milion leke.

Shpenzimet e Personelit		
Fondi i pagave	min ALL	893.0
Pagesa për turne dhe orë jashtë orarit	"	65.8
Shpenzime ushqimi për punonjësit	"	141.5
Shpenzime për udhëtime dhe diëta	"	33.0
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	"	212.2
Shpenzime page për vjetërsi në punë	"	100.0
Fondi suplementar i pensionit	"	134.0
Shpenzime te tjera Personeli	"	25.8
Paga 13	"	84.6
Totali	min ALL	1,689.8
Nr. mesatar i punonjësve	Nr.	817
Paga mesatare	ALL	91,088

Për vitet 2026 dhe 2027, kostot e personelit janë parashikuar duke u indeksuar me një rritje rreth 3% në vit.

✓ **Shërbimet administrative e të tjera**

Në këtë zë përfshihen Shërbimet me fondet e veta për vitin 2025 si dhe shpenzimet periodike që OST sh.a. kryen për funksionimin e saj (si psh: mirëmbajtja e platformave dhe sistemeve të ndryshme të operimit, mirëmbajtja e godinave, mirëmbajtja e automjeteve, ruajtja e objekteve, shpenzimet e kryera nga të tretë për shërbime dhe mirembajtje, ujë, siguracione, pagesat e ERE etj). Për vitin 2025, janë parashikuar rreth 820 milionë lekë për këto shërbime të domosdoshme për OST sh.a.. Në mënyrë më të detajuar, paraqiten si më poshtë:

Nr.	Shërbime administrative e të tjera	Vlera Lekë
1	Organizma Rajonale	131,000,000
2	Mirembajtje platforma dhe sisteme SOFTWARE	125,000,000
3	Sherbime te ndryshme detyrimet kontraktuale me OST-te e Europes Kontinentale	58,552,000
4	Ruajtje Objekte	179,826,113
5	Cyber Security	5,840,000
6	Mirembajtja e automjeteve	30,000,000
7	Automjete me qera	18,660,000
8	Sigurim jete dhe shendeti	15,000,000
9	Mirembajtje ambjentesh	30,000,000
10	Kerkime studime	10,000,000
11	Eksperte Kontabel dhe Vleresues	30,000,000
12	Shërbim Teknik me jashte, aplikime, pjesmarje	10,000,000
13	ERE	25,000,000
14	Kompesimi i disbalancave në rast të ndërprerjeve të energjisë në rrjetin e transmetimit si pasojë e avarive në sistem*	23,740,200
15	Sherbime mirembajtje dhe sherbime te tjera te telekomunikacionit	32,630,000
16	Hartimi i Planit të Mbrojtjes se Sistemit të OST sh.a.	40,000,000
17	Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	5,000,000
18	Keshilli Mbikqyres	4,173,600
19	Shpenzime për shërbimet bankare	2,500,000
20	Sigurime	2,400,000
21	Publicitet, reklama	1,400,000
22	Taksa, tatime dhe tarifa të tjera	15,000,000
23	Te tjera	24,000,000
Totali Shërbimet administrative e të tjera		819,721,912

Per vitet 2026 dhe 2027, këto shpenzime jane parashikuar të jenë përkatësisht 836 milionë leke dhe 853 milionë lekë.

*** Kompesimi i disbalancave në rast të ndërprerjeve të energjisë në rrjetin e transmetimit si pasojë e avarive në sistem:**

Vendimi Nr 106 /2020 ERE “Mbi Miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” parashikon se kompensimi i disbalancave të cilat shkaktohen nga shkeputja e përdoruesve të lidhur në Rrjetin e Transmetimit, në raste të avarive në rrjet, duhet të mbulohen nga OST. Energjia e munguar si pasojë e avarive të shkaktuara në rrjetin e OST, për të cilën Përdoruesit duhet të kompesohen janë përlllogaritur duke marrë në konsideratë eksperiencën shumë vjecare të menaxhimit të sistemit por gjithashtu edhe referuar të dhenave statistikore të mbajtura nga OST për vitin 2024.

Nga eksperiencia e deritanishme rezulton se sasia e energjise se ‘munguar’ qe duhet te kompensohet eshte e rendit 2,178 MWh ne vit.

Perdoruesi konsumator (Furnizuesi si PPB i cili ka nje kontrate furnizimi me perdoruesin konsumator) nuk penalizohet me disbalance pozitive, por kompensohet nga OST me cmimin e blerjes se energjise nga furnizuesi perkates

Perdoruesi gjenerues nuk penalizohet me disbalance negative. Disbalanca e krijuar mbulohet nga OST.

Viti	Sasia e energjise qe duhet te kompensohet nga OST [MWh]	Cmimi mesatar [€/MWh]	Fondi [€]	Fondi [Mln Leke]
2025	2,178	108.5	236,226	23.7
2026	2,000	119.2	238,474	24.0
2027	1,800	130.2	234,328	23.6

✓ *Menaxhimi i kongestionit me ridispecim*

Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për dispeçerimin e energjisë elektrike nga centralet prodhuese në funksion të sigurisë së punës së Sistemit dhe sigurisë së furnizimit, pa ndikuar në detyrimet kontraktore të furnizimit me energji elektrike. Aktet rregullatore në fuqi, Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike miratuar me Vendimin ERE 106/2020 dhe Kodi i Transmetimit i miratuar me Vendimin ERE 63 datë 11.04.2022, i japin detyrimin OST të kompesojë perdoruesit e rrjetit të cilët në bazë të kërkesës së bërë nga OST (ulin ose rrisin gjenerimin në një pikë të caktuar të injektimit në rrjet, për të ciluar konxhestionet).

Për të ciluar konxhestionin në rrjet, në rastet kur shfaqet, aplikohet ridispecimi, që nënkupton uljen e gjenerimit në një pikë të caktuar të injektimit në rrjet, dhe rritjen respektive të gjenerimit në një pikë tjetër të injektimit në rrjet, ose sipas rastit vetëm uljen apo rritjen e gjenerimit në funksion të konxhestionit të krijuar. Ky ndryshim i gjenerimit, krahasuar me programin e kontraktuar që ka deklaruar pjesmarresi përkates në treg, duhet të kompensohet nga OST, si në rastin e uljes, ashtu edhe në rastin e rritjes së gjenerimit, për një periudhe të caktuar kohore që vlerësohet nga Operatori.

Për përmasat e Sistemit tonë është vlerësuar i mjaftueshem kapaciteti prej 100 MW (±50MW). Numri i ditëve potencialisht të mundëshme për aplikimin e ridispecimit është marrë 100, dhe me një kohëzgjatje të mundëshme prej 6 orë, për cdo rast ridispecimi. Cmimi i këtij lloj shërbimi është marrë i përafërt me cmimin e injektimit të energjisë nga PPE-të me koncension.

Viti	Kapaciteti [MW]	Nr. Ditëve	Kohëzgjatja në ore per cdo ditë të mundeshme	Sasia [MWh]	Cmimi mesatar [€/MWh]	Fondi [€]	Fondi [Mln Leke]
2025	100	100	6	60,000	108.5	6,507,600	654
2026	100	100	6	60,000	119.2	7,154,215	719
2027	100	100	6	60,000	130.2	7,810,930	785

✓ *Materiale të para*

Shpenzimet e materialeve përfshijnë të gjitha materialet që përdoren në mirëmbajtjen e linjave, nën-stacioneve, godinave, karburanti dhe kancelaritë. Në llogaritjen e vlerës së këtij zëri jemi nisur nga realizimet faktike disa vjecare, programin e realizimit të pritshëm për vitin 2024 si dhe në kërkesat kryesore të Njesive, për kryerjen e aktivitetit normal të punës së tyre. Për vitin 2025 shpenzimet për materiale të para parashikohet të jenë 167 milionë lekë. Në mënyrë më të detajuar, paraqiten si më poshtë:

Materiale të para		
Blerje Lëndë djegëse.	ALL	50,000,000
Blerje Kancelarie	ALL	3,000,000
Blerje materiale për Njesite Operative	ALL	114,000,000
TOTAL	ALL	167,000,000

Për vitet 2026 dhe 2027, këto shpenzime janë parashikuar të jenë përkatësisht 169 milionë leke dhe 171 milionë lekë.

✓ *Prokurimi i humbjeve të energjisë në rrjetin e transmetimit*

Në bazë të Ligjit Nr. 43/2015 për sektorin e energjisë elektrike, Operatori i Sistemit të Transmetimit prokuron energjinë elektrike për të mbuluar humbjet në rrjet, shërbimet e balancimit ose ato ndihmese të nevojshme për funksionimin e sistemit, nepermjet një procedure konkurruese, jodiskriminuese dhe transparente.

Për vitin 2025, humbja e energjisë në rrjet është vlerësuar në rreth 228 GWh. Kjo sasi energjie do të blihet me bazë tregu, duke konsideruar një çmim mesatar vjetor prej rreth 111.8 €/MWh. Fondi që kërkohet për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 25.49 milion euro ose 2,549 milionë lekë.

Për vitin 2026 humbja e energjisë në rrjet është vlerësuar në rreth 234 GWh. Kjo sasi energjie do të blihet me bazë tregu, duke konsideruar një çmim mesatar vjetor prej rreth 101.28 €/MWh. Fondi që kërkohet për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 23.66 milion euro ose 2,366 milionë lekë.

Për vitin 2027 humbja e energjisë në rrjet është vlerësuar në rreth 247 GWh. Kjo sasi energjie do të blihet me bazë tregu, duke konsideruar një çmim mesatar vjetor prej rreth 89.87 €/MWh. Fondi që kërkohet për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 22.22 milion euro ose 2,222 milionë lekë.

✓ *Prokurimi i kapacitetit rregullues dhe atij rezerve për shërbimin e balancimit*

Në bazë të Kodit të Transmetimit dhe Manualit të Operimit të ENTSO-E (SO-GL), OST duhet të prokurojë rezervën balancuese të nevojshme për ruajtjen e balancës të zonës së kontrollit në mënyrë të vazhdueshme. Rezerva balancuese përbëhet nga rezerva primare (FCR) dhe ajo sekondare automatike (aFRR) dhe manuale (mFRR). Duke qenë se deri në këto momente, është operuar me sigurimin e rezervës sekondare automatike (aFRR), parashikimet janë bërë duke konsideruar këtë tip rezerve.

Kështu në kushtet e prokurimit të rezervës në bazë tregu duke patur parasysh hyrjen në fuqi të Tregut Balancues nga një mesatare e çmimeve rezultuar deri më tani si dhe çmime të rajonit, fondi që kerkohet për blerjen e ketij shërbimi është rreth 17.6 milion euro. Ndërsa për vitet në vijim referuar dhe tabelave si më poshtë, parashikohet për vitin 2026 një fond rreth 19.5 milion euro, për vitin 2027 një fond rreth 23.8 milion euro.

Produkti	Viti 2025			Viti 2026			Viti 2027		
	Sasia	Çmimi mesatar	Fondi	Sasia	Çmimi mesatar	Fondi	Sasia	Çmimi mesatar	Fondi
	[MW]	[€/MW]	[€]	[MW]	[€/MW]	[€]	[MW]	[€/MW]	[€]
aFRR+	254,239	47.43	12,058,554	266,951	49.99	13,345,728	280,298	58.13	16,293,692
aFRR-	151,080	36.64	5,536,087	158,634	38.62	6,127,029	166,566	44.91	7,480,441
Total	405,319	43.41	17,594,641	425,585	45.76	19,472,757	446,864	53.20	23,774,133

✓ Shpenzimet për ITC

Për përcaktimin e vlerës së ITC për vitin 2025, janë marrë në konsideratë të dhënat disavjecare të pagesave për këtë zë. Këto pagesa janë në proporcion të drejtë me marrëdhëniet e shkëmbimit të energjisë me shtetet e tjera. Mekanizmi tek i cili bazohet llogaritja e ITC është “Pan-European Inter -TSO Compensation Mechanism”. Ky mekanizëm është projektuar për të kompensuar palët për shpenzimet që lidhen me humbjet që rezultojnë nga bartja e flukseve të energjisë në sistemet e tyre.

Duke ndjekur trendin disavjekar të ITC si dhe parashikimin e energjië, shpenzimet për CBT parashikohen të jenë rreth 300 milionë lekë për çdo vit, gjatë periudhës 2025-2027.

C. Të ardhurat nga aktivitete të tjera

Në vlerësimet e treguesve për periudhën 2025-2027, nga ana e OST sh.a., janë parashikuar dhe të ardhura të tjera të cilat nuk vijnë nga aktiviteti i shërbimit të transmetimit, dhe këto të ardhura merren në konsideratë dhe zbriten nga të ardhurat e kërkuara në përlogaritjen e tarifës së transmetimit.

Këto të ardhura parashikohen si në tabelën e mëposhtme:

Të ardhura nga Aktivitete të tjera	Njesia	2025	2026	2027	2025-2027
Të ardhura nga alokimi i kapaciteteve	Mln Leke	1,660	1,760	1,800	5,220
Të ardhura nga telekomunikacioni	“”	70	70	80	220
Të ardhura nga grantet	“”	50	75	80	205
Të ardhura të tjera	“”	25	30	35	90
Totali i të ardhurave nga aktivitete të tjera	Mln Leke	1,805	1,935	1,995	5,735

VII. Tarifa aktuale – Periudha rregullatore 2022-2024

Me vendimin Nr. 72, datë 13.04.2022 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2022-2024”, Enti Rregullator i Energjisë, ka miratuar tarifën mesatare të transmetimit në masën 0.85 lekë/kWh për periudhën rregullatore 1 maj 2022 - 31 dhjetor 2024.

Pasqyrimi i efekteve të aplikimit të kësaj tarife, duke marrë në konsideratë të dhënat faktike te viteve 2022, 2023, 6 Mujori I 2024 si dhe vlerësimet më të fundit për rezultatin e pritshëm të vitit 2024, pasqyrohet si mëposhtë:

Emertimi	Njesia matëse	OST Aktuale			
		2022	2023	2024	2022-2024
Energjia Totale që hyn në sistemin e OST	GWh	9,547	10,147	10,296	29,990
Prodhim vendas	"	6,504	8,226	7,707	22,436
Energji në marrje	"	3,044	1,922	2,589	7,554
Energjia totale e transmetuar	GWh	9,347	9,927	10,081	29,356
Energji elektrike e dhënë	"	2,123	2,842	2,658	7,622
Energji elektrike për OSHEE sh.a.	"	6,546	6,492	6,788	19,826
Energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar	"	679	594	635	1,908
Humbjet në GWh	GWh	200	220	214	634
Humbjet në %	%	2.09%	2.17%	2.08%	2.12%
Konsumi	GWh	7,225	7,086	7,423	21,733
Çmimi i blerjes së Energjisë humbjet	EUR/MWh	142.92	88.46	90.56	106.33
Vlera e humbjeve	EUR	28,582,981	19,483,739	19,395,620	67,462,340
Vlera e humbjeve	Mln leke	3,116	2,124	1,940	7,179
C Operuese	Mln leke	6,191	5,698	5,756	17,645
Energjia	Mln leke	3,881	3,308	3,355	10,543
- Humbjet	"	3,116	2,124	1,940	7,179
- Sherbimet Ndihmese	"	535	806	1,101	2,442
- Menaxhimi i kongjestionit me ridispecim	"	0	0	0	0
- TTC	"	231	378	314	922
Kosto shfrytëzimit	Mln leke	2,310	2,390	2,402	7,102
- Personeli	"	1,247	1,201	1,519	3,968
- Materiale	"	116	103	119	338
- Furnitura & Sherbime	"	947	1,086	764	2,796
Investimet e vitit	Mln leke	2,595	3,435	7,664	13,694
D - Amortizimi	Mln leke	2,253	2,563	2,534	7,350
B - Baza e rregulluar e aseteve	Mln leke	33,029	33,900	39,031	105,960
WACC¹	%	7.13%	5.15%	2.55%	4.81%
R - Kthimi mbi kapitalin (R = B*WACC)	Mln leke	2,355	1,746	997	5,098
C kapital= R+D	Mln leke	4,608	4,309	3,531	12,448
C - Ardhurat kerkuara (C operuese + C kapital)	Mln leke	10,800	10,007	9,287	30,093
Te ardhurat nga aktivitetet tjera	Mln leke	4,925	3,957	2,977	11,858
Ardhura tjera qe zbriten nga te ardhurat e kerkuara	"	4,925	3,957	2,977	11,858
Rregullime per periudhat e meparshme rregullatore	"				
Ardhurat kerkuara neto	Mln leke	5,875	6,050	6,310	18,235
Tarifa mesatare e transmetimit	leke/kWh	0.81	0.85	0.85	0.84

Nëse do t'i referohemi normës së WACC, të miratuar nga ERE në nivelin 2.28%, të ardhurat e kërkuara për këtë periudhë rregullatore rezultojnë të jenë në një nivel më të lartë sesa ajo e parashikuar në Vendimin Nr. 72, datë 13.04.2022 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2022-2024”, përkatësisht:

Emertimi	Njesia matëse	2022	2023	2024	2022-2024
----------	---------------	------	------	------	-----------

¹ Norma korresponduese e WACC per nivelin e miratuar te tarifës


Te ardhurat e kerkuara të realizuara mbi parashikimin	Mln leke	1,824	1,199	-67	2,955
---	----------	-------	-------	-----	-------


Në vijim të përlogaritjes së tarifës mesatare të transmetimit për periudhën rregullatore 2025-2027, këto të ardhura janë parashikuar si të zbritshme nga të ardhurat e kërkuara për këtë periudhë, dukë bërë kështu të mundur rregullimet e nevojshme në lidhje me tarifën mesatare të transmetimit të kërkuar.

Referuar këtyre rezultateve, komponentët e tarifës mesatare të transmetimit paraqiten si më poshtë vijon:

Tarifa mesatare sipas komponenteve		OST Aktuale			
		2022	2023	2024	2022-2024
KOMPONENTET E KOSTOVE NE TARIFEN MESATARE TE TRANSMETIMIT (milione leke)					
Energjia	Mln leke	2,111	2,000	2,279	6,389
Kosto shfrytëzimit	Mln leke	1,257	1,445	1,632	4,303
Kosto Kapitali	Mln leke	2,507	2,605	2,399	7,543
KOMPONENTET E KOSTOVE NE TARIFEN MESATARE TE TRANSMETIMIT (leke/kWh)					
Energjia	leke/kWh	0.29	0.28	0.31	0.29
Kosto shfrytëzimit	leke/kWh	0.17	0.20	0.22	0.20
Kosto Kapitali	leke/kWh	0.35	0.37	0.32	0.35
TARIFA MESATARE TE TRANSMETIMIT (leke/kWh)	leke/kWh	0.81	0.85	0.85	0.84

Në mënyrë grafike, ndarja e komponentëve të tarifës mesatare të transmetimit, paraqitet si më poshtë:





VIII. Llogaritja e Tarifave – Periudha Rregullatore 2025-2027

Duke marrë në konsideratë;

- Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit;
- Realizimin faktik të treguesve për periudhën Janar-Qershor të vitit 2024;
- Pritshmërinë e realizimit të treguesve për vitin 2024;
- Vlerësimet e treguesve dhe parashikimin e tyre për vitet 2025-2027;
- Sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të OST sh.a.;
- Minimizimin e ndikimeve tek konsumatorët dhe operatorët e tjerë;

NDERTIMI I LINJES 220 KV ME DY QARQE KOMSI-SHUMAT

FINANCIMI: Ky projekt është financuar me fondet e OST. Gjatë periudhës 2022-2024, ky projekt pritet të realizohet plotësisht.

PËRFITIMET: Rrit kapacitetin pritës të rrjetit elektrik në segmentet Fierzë – Fushë Arrëz – Kukës – Lapaj – Peshkopi – Bulqizë – Burrel që përfaqëson një unazë 110 kV me një shtrirje në të gjithë zonën verilindore të vendit, në të cilën janë lidhur dhe janë në proces ndërtimi një numër i madh burimesh hidrike.

Synon operimin optimal të burimeve hidrike të zonës dhe një furnizim cilësor për konsumatorët e zonës.

Rrit sigurinë nëpërmjet reduktimit të numrit të stakimeve dhe kohës së ndërprerjeve tek HEC-et ekzistues dhe konsumatorët e zonës.

Ndikon në reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike dhe përmirësimin e profilit të tensionit.

NDERTIMI I LINJES SË RE ME DY QARQE 110 KV BURREL - BULQIZË DHE REHABILITIMI I N/ST 110 KV BURREL E BULQIZË

FINANCIMI: Ky projekt është financuar me fondet e OST. Gjatë periudhës 2022-2024, ky projekt është realizuar plotësisht.

PËRFITIMET: Rritje e kapaciteteve dhe e sigurisë së furnizimit me energji elektrike. Reduktimi i humbjeve me 0.79%, reduktimi i energjisë së mosfurnizuar, shtim të kapaciteteve transmetuese nga 70 MW në 246 MW. Ulje e kostove të mirembajtjes.

RIKONSTRUKSION I LINJES 110 KV LUSHNJE - FIER

FINANCIMI: Ky projekt është financuar me fondet e OST. Gjatë periudhës 2022-2024, ky projekt pritet të realizohet plotësisht.

PËRFITIMET: Rritje e kapaciteteve dhe e sigurisë së furnizimit me energji elektrike. Reduktimi i humbjeve me 0.75%, reduktimi i energjisë së mosfurnizuar, shtim të kapaciteteve transmetuese nga 70 MW në 123 MW. Ulje e kostove të mirembajtjes

FURNIZIM VENDOSJE E QARKUT TE DYTE TE LINJES 220 KV TEC FIER-BABICE-TEC VLORE

FINANCIMI: Ky projekt financohet me fondet e OST sh.a.

PËRFITIMET: Rritje e kapaciteteve transmetuese dhe aksesit të burimeve të reja të prodhimit të energjisë së rinovueshme

B. Projektet e Investimeve me fondet e Huaja për periudhën rregullatore 2022-2024

Në mënyrë të detajuar, realizimi i investimeve për këtë periudhë paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi	Vlera e Kontraktit (lekë)	Vlera realizuar deri 2021 (lekë)	Realizimi 2022 (lekë)	Realizimi 2023 (lekë)	Realizimi 2024			
						Realizimi 6 Mujorë I (lekë)	Realizimi I Prillit të 6 Mujorë II (lekë)	Realizimi I Prillit të 2024 (lekë)	%
1	Eficienta energjike programi per sektorin e nergjise elektrike	4.832.586.214	797.054.389	1.063.450.369	941.680.531	206.979.412	986.007.616	1.192.987.028	83%
2	Linja 400 kV Shqipëri - Maqedoni Tranche I & Tranche II	6.699.102.791	177.470.434	122.367.187	451.418.259	910.424.869	1.919.990.280	2.830.415.149	55%
Totali i investimeve te reja 2022-2024		11.531.689.005	974.524.823	1.185.817.576	1.393.098.790	1.117.404.281	2.905.997.896	4.023.402.177	66%

Ndër projektet kryesore të investimeve të realizuara gjatë kësaj periudhe janë:

PROJEKTI “PROGRAMI I EFIÇENCËS SË ENERGIJISË TË SEKTORIT TË TRANSMETIMIT” -LOTI 1- NËNSTACIONET DHE LOT 2- LINJAT

FINANCIMI: Ky projekt financohet nga një kredi prej 40,000,000 Euro e akorduar nga Qeveria Gjermane, nëpërmjet Bankës KfW.

PËRFITIMET: Ky projekt do të bëjë të mundur rritjen e besueshmërisë së funksionimit të rrjetit 220 kV të rajonit të Durrësit dhe të Jugut të Shqipërisë duke plotësuar kriteret teknike të sigurisë dhe cilësisë. Gjithashtu ky projekt do të përmirësojnë kushtet aktuale të furnizimit me energji elektrike të qytetit të Tiranës, duke konsideruar që një pjesë e rëndësishme e rrjetit unazor 110 kV që furnizon me energji elektrike nënstacionet e sistemit të shpërndarjes në zonën e Tiranës, i ndërtuar përpara mbi 40 vjetësh i përbërë nga linja ajrore të amortizuara dhe kapacitet transmetimi të limituar.

NDËRTIMI I LINJËS SË INTERKONJEKSIONIT 400 KV ELBASAN2 (SHQIPËRI) – BITOLA (MAQEDONI) DHE ELBASAN2 – FIER SI DHE SI DHE ZGJERIMI I NËNSTACIONEVE ELBASAN2 DHE FIER


FINANCIMI: Financimi i këtij projekti, do të sigurohet nga Bashkëpunimi Gjermano-Shqiptar i Zhvillimit. Tashmë janë angazhuar fondet për një kredi të zhvillimit deri në 50.000.000 Euro për Qeverinë Shqiptare. Përveç kësaj, për të mbuluar financimin e plotë të projektit, do të vihet në dispozicion një grant nga WBIF prej 13.720.000 Euro. Gjithashtu, rreth 1.131.000 Euro, do të angazhohen nga WBIF dhe Bashkëpunimi për Zhvillim Gjermano-Shqiptar, fonde të cilat do të përdoren për përgatitjen e dizajnit kryesor. OST sh.a., është angazhuar të mbulojë gjatë implementimit të projektit dhe kostot lokale, të cilat janë përllogaritur të jenë rreth 5 milion Euro.

PËRFITIMET: Ky projekt përforcon lidhjet interkonektive me rrjetin rajonal të energjisë elektrike, duke krijuar kushte për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajon, zhvillon rrjetin 400 kV në zonën Jugore të Shqipërisë ku parashikohen të zhvillohen burimet e ardhshme të prodhimit të energjisë elektrike, dhe si pjesë e infrastrukturës së Korridorit të Tetë Evropian.

V. Parashikimi i Investimeve 2025-2027


Gjatë viteve 2025-2027, OST sh.a., parashikon të kryejë rreth 16 miliardë lekë investime, nga të cilat, rreth 27 % të financuara me fonde të huaja, ndërsa pjesa tjetër parashikohet të bëhet me fondet e OST sh.a.:

Sipas burimeve të financimit	Njësia	2025	2026	2027	2025-2027
Burimet e veta	Mln. Lekë	4,324.8	3,887.3	3,513.0	11,725.0
Ndihmë dhe kredi e huaj	Mln. Lekë	4,303.9	0.0	0.0	4,303.9
Totali i Investimeve	Mln. Lekë	8,628.6	3,887.3	3,513.0	16,028.8



Realizimi i Investimeve sipas natyrës së projekteve për këtë periudhë, paraqitet si më poshtë vijon:

(Vlerat në milionë lekë)	2025	2026	2027	2025-2027
Nenstacione	4,246.0	779.3	350.0	5,375.2
Linja 220 kV dhe 400 kV	2,439.2	674.3	536.4	3,649.8
Linja 110 kV	1,862.5	2,111.7	2,429.5	6,403.8
IT; Cyber; Telekomunikacion	81.0	322.0	197.0	600.0
Tjera	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali	8,628.6	3,887.3	3,513.0	16,028.8



C. Projektet e Investimeve me fondet e OST për periudhën rregullatore 2022-2024

Në mënyrë të detajuar, Parashikimi i investimeve për këtë periudhë paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi	Vlera Kontrates	PLAN 2025-2027		
			Realizimi 2025	Realizimi 2026	Realizimi 2027
1	Ndërtimi i linjes së re 220 kV dopio qark Fier-Hoxhare me perçjelles ACSR 490/65 si dhe ndërtimi i N/st te ri 220/110/20 kV Hoxhare, bashke me dy dalje 220 kV	1,342,103,054	298,986,806		
2	Zhvillimi i skemes dhe rikonstruksioni i N/st 220/110/35/20 kV Sharre	435,825,292	150,000,000		
TOT Kontrata te vitit 2023		1,777,928,346	448,986,806	0	0
1	Rikonstruksion i segmentit te pare te linjes 110 kV Balish-Marinez dhe Balish-Drenove	243,842,512	133,842,512		
2	Ndërtim vendrojm dhe furnizim vendosje shelter per OST sh.a	2,057,867	5,599		
3	Spostim i dy linjave kablore 35 kV, të cilat ndodhen brenda territorit të N/Stacionit të ri 220/110/20 kV Hoxharë	3,422,252	143,917		
4	Instalim qarku 110kV në linjën ekzistuese Bushat - Velipojë	143,000,000	114,400,000		
5	Ndërtimi i linjes kablore 110 kV Tirana 1 – Zogu i Zi si dhe trakti perkates ne N/St Tirana 1	290,000,000	182,000,000		
6	Ndërtimi i linjës së re 110 kV Gjiri i Lalzit – F.Kuçe	392,700,000	314,160,000		
7	Rikonstruksioni i linjes 110 kV Fier-Marinez	300,000,000	262,400,000		
8	Furnizim Vendosje e 1 faze te Autotransformatorit 400/220 kV 115 MVA Koman	320,000,000	176,000,000	80,000,000	
9	Riparimi I fazes "C" te AT 400/220 kV 115MVA Koman	160,000,000	128,000,000		
10	Rikonstruksion I linjes 110 kV Memaliaj - Tepelene dhe I trakteve te linjes ne N/ST Tepelene	225,000,000	129,140,745	50,859,255	
11	Ndërtimi i 2 trakteve te rinje linje 220 kV ne N/St Fier dhe Babice	135,000,000	108,000,000		
12	Faza 2 e punimeve ne Nenstacionin 220/110/20kV Hoxhare	180,000,000	144,000,000		
13	Kalimi ne kabllor i segmentit te pare te linjes 110 kV Farke - Ibe	52,500,000	10,500,000		0
14	Kalimi në kabllor i segmentit të linjes 110 kV Traktora – Farkë, në hyrje të N/St Farkë	147,000,000	97,000,000		
15	Furnizimi dhe instalimi i konteneirit te assembluar me cela 20 kV ne NST Tirana 1	80,000,000	64,000,000		0
16	Ndërtimi i linjes 110 kV Sarandë - NST Xarrë me linje me shtylla dopio qark dhe shtrirje te perçjellesit ne nje qark. Si dhe trakti perkates i linjes 110 kV ne NST Sarandë	315,000,000	59,720,356	138,881,424	100,000,000
17	Ndërtimi i linjes 110 kV Zogu i Zi – Trana Qender dhe Punime në N/st Tirana Qendër	230,000,000	46,000,000	95,000,000	89,000,000
18	Zgjerimi i N/st Tiranal (Trakt i ri transformatori 220 kV, ndërtim i seksionit të tretë 20 kV)	300,000,000	110,000,000	100,000,000	70,000,000
19	Rikonstruksioni i linjes 110 kV Lushnje-Kavaje	538,740,000	107,748,000	351,446,400	79,545,600
20	Zgjerim i Nst F. Kruje me nje auto 220/110 kV dhe traktit te ri 220 kV nga fabrika e cimentos (faza 2)	451,198,628	90,239,726	172,900,000	80,000,000
21	Ndërtimi i linjës së re 110kV HEC Lurë- Shumat se bashku me traktet perkatese	410,129,839	82,025,968	217,974,032	110,129,839
22	Rehabilitimi i anes 110kV N/St F. Kruje dhe godina (Faza 1)	206,423,700	66,000,000	140,423,700	
23	Ndërtimi i linjes se re Corovode Kelyre tek qark si dhe traktet perkatese	451,500,000	90,300,000	212,500,000	100,000,000
24	Ndërtimi i linjes se re 110kV Gjiri Lalzit - Porto Romano dhe traktet perkatese	360,000,000	72,000,000	165,913,092	122,086,908
25	Rikonstruksion i linjes Fier - Kafaraj dopio qark dhe trakti i ri linje 110 kV ne NST Fier	270,000,000	88,000,000	182,000,000	
26	Fuqizim i linjes 110 kV Kafaraj - Viora 1 - Babice dopio qark dhe shtrirje perçjellesi ne nje qark	504,000,000	75,800,000	200,000,000	150,000,000
27	Zgjerimi i kapaciteteve DATA dhe shtimi i pikave te reja te aksesit ne rjetin komercjal	405,047,320	81,009,464	283,028,392	41,009,464
28	Linja e re dopio qark Sharre - Selite dhe traktet perkatese	620,000,000	98,124,000	133,475,608	248,400,392
29	Linja e re kablore 110 kV Tirana qender- Pallati kongresve	180,000,000	36,000,000	144,000,000	
30	Rikonstruksioni N/st 220/110/35 kV Sharre, Faza 2	400,000,000	80,000,000	170,000,000	
31	Linjë e re 110kV Velipojë (kufi Mal i Zi)	180,000,000	44,325,238	135,674,762	
32	Upgrade dhe mirembajtje e sistemit SCADA/AGC te qendres emergjente te kontrollit	195,000,000	39,000,000	156,000,000	
33	Ndërtimi i linjes se re kablore dopio qark 110 kV AL (1x1000) mm² N/ST. Rrshbull - N/ST. Shkozet	385,223,172	77,044,634	155,178,538	
34	Rikonstruksion i linjes 110 kV Lac 1 - Fush Kuqe dhe trakti perkates ne NST Fush Kuqe	150,000,000	30,000,000	120,000,000	
35	Ndërtim i linjes se re Kashar - Lac 1 dhe demontimi I linjes ekzistuese	920,000,000	184,000,000	150,000,000	
36	Ndërtim i linjes se re Lac 2 - (Lezhe) - Bushat I ri dhe demontimi i linjes ekzistuese	892,000,000	178,400,000	200,000,000	
37	Ndërtim i perçjellesit te linjes 220 kV Burrel - Elbasan 1 me perçjelles HTLS	610,000,000	122,000,000	188,000,000	
38	Ndërtimi i nje segmenti te ri linje 110 kV per te anashkaluar aytetin e Gjirokastres	112,000,000	22,400,000	89,600,000	
39	Ndërtimi i Linjes se re Kablore Tirana 1 - Traktora	540,000,000		68,000,000	
40	Ndërtimi i Linjes se re Tirana 3 - Traktora	630,000,000		85,000,000	
41	Rikonstruksion I trakteve te linjes dhe sistemit te zbarrave te N/St Balsh	212,000,000		42,400,000	
42	Segmenti i dyte i linjes Memaliaj - Balsh	565,714,286		113,142,857	
43	Segmenti i dyte i linjes Jagodine - Balsh	257,142,857		51,428,571	
44	Segmenti i linjes Drenove - Selenice	102,857,143		20,571,429	
45	Dy trakte te reja 110 kV hyrje-dalje ne nst e Drenoves	121,900,000		24,380,000	
46	Dy trakte te reja 110 kV hyrje-dalje ne nst e Krahesit	158,470,000		31,694,000	
47	Dy trakte te reja 110 kV hyrje-dalje ne nst e Kelyres	132,500,000		26,500,000	
48	Qarku i dyte i linjes 110 kV Viora 2 - Babice	131,500,000		26,300,000	
49	Dy trakte te reja 110 kV hyrje-dalje ne nst e Gjirokastres se vjeter	106,000,000		21,200,000	
50	Ndërtimi i sistemit te ri te zbarrave 110 kV ne N/ST Kafaraj dhe 3 trakte te reja linje	275,000,000		55,000,000	
51	Rikonstruksion i trakteve te nenstacionit Erseke dhe realizimi I skemes Hyrje dalje ne kete NST	150,000,000		30,000,000	
52	Ndërtimi i një linje të re ajrore 110kV ndërmjet Shqipërisë (Nst Bajram Curri) dhe Kosovës (Nst Deçan)	569,588,400		113,917,680	
53	Mbikqyrje e punimeve	369,980,218	87,620,415	137,465,788	104,791,164
TOT Kontrata te vitit 2024 -2027		16,083,439,194	3,018,180,702	3,475,037,563	3,512,951,204
TOTALI INVESTIME		17,861,366,540	3,467,167,508	3,475,037,563	3,512,951,204


Ndër projektet kryesore të investimeve të parashikuara gjatë kësaj periudhe janë:

RIKONSTRUKSION I LINJES 110 KV FIER – MARINEZ

Aktualisht OST ka përfunduar rikonstrukcionin e linjës 110 kV Cërrik – Kajan – Kuçove – Jagodine. Këto linja 110 kV janë ndërtuar te reja me përcjellës ACSR 240/40 mm² duke ofruar siguri shtese për konsumatorët e zonës dhe gjithashtu duke rritur kapacitetet e transmetimit të linjave në fjale.

Aktualisht në implementim është dhe linja 110 kV Elbasan – Cërrik fakt që do të beje të mundur rikonstrukcionin e komplet linjave që lidhin N/ST Elbasan me N/ST Fier përveç segmentit Fier – Jagodine.

Nëpërmjet këtij projekti planifikohet rikonstrukcioni i kësaj linje dopjo qark me përcjellës ACSR240/40 mm² duke rritur në mënyrë të ndjeshme kapacitetet e transmetimit të linjave Fier – Elbasan por gjithashtu dhe në drejtim të Fier – Ballsh – Memaliaj.



FURNIZIMI I NST TEPELENE NGA LINJA 110 KV MEMALIAJ - KËLCYRE DHE RIKONSTRUKSION I TRAKTEVE NË NST TEPELENE

Nënstacioni Tepelene ka një distancë nga nënstationi Memaliaj prej gati 6 km. Linja që lidh këta dy nënstacione është relativisht e amortizuar dhe në gjendje të keqe teknik, për më tepër linja në hyrje të nënstationit Memaliaj ndodhet në afërsi dhe sipër objekteve në zonë. Si pjesë e këtij projekti propozohet furnizimi i nënstationit Tepelene nga linja 110 kV Memaliaj - Këlcyre nëpërmjet çarjes së kësaj linje 110 kV dhe me një segment të ri linje prej përafërsisht 500 m. Gjithashtu si pjesë e këtij projekti planifikohet rikonstrukcioni i trakteve të linjës së nënstationit Tepelene dhe zgjerimi i këtij nënstacioni me një trakt linje shtese. Linja ekzistuese Memaliaj Tepelene pas realizimit të investimit pritet të demontohet.




Figura 1: Skema aktuale e furnizimit te nenstacionit Tepelene




Figura 2: Skema e furnizimit te nenstacionit Tepelene pas realizimit te investimit

FUQIZIMI I LINJAVE 110 KV FIER-KAFARAJ-VLORAI-BABICË DHE 110 KV LUSHNJË-KAVAJË

Në këtë skemë është marrë në konsideratë dhe fuqizimi i linjës 110 kV Lushnjë-Kavajë, në funksion të rehabilitimit të plotë të traktit 110 kV Rrashbull-Fier, nisur dhe nga rezultatet e mësipërme të mosplotësimit të kriterit N-1 nga mbingarkimi i kësaj linje në disa raste kontigjencash. Shpërndarja e flukseve të fuqisë në këtë rast është:




Fig. 3 Skema me fuqizimin e linjave 110 kV Fier-Kafaraj-Vlorai-Babice dhe 110 kV Lushnje-Kavaje

Rezultatet e analizës së kontigjencave N-1 për këtë skemë për rrjetin në zonë paraqiten në tabelë:

Tab. 1 Tabela përmbledhëse e kontigjencave për skenarin me fuqizim të plotë

Kontigjenca	Elementi i monitoruar	Ngarkimi (%)	Kapaciteti (MVA)
110 kV Fier - Kafaraj	110 kV Babicë - Selenice	92.4	64

Nisur nga këto rezultate mund të evidentohen dy konkluzione të rëndësishme për skemën optimale të fuqizimeve në rrjetin 110 kV:

- i. Në çdo variant të mundshëm të skemës finale nevojitet fuqizimi i **njëkohshëm** i linjave 110 kV Fier-Kafaraj-Vlora1-Babicë dhe 110 kV Lushnjë-Kavajë, me qëllim eliminimin e plotë të thujse të gjithë rasteve të mbingarkimit të këtyre linjave në rast stakimi të elementeve të rrjetit.
- ii. Për arritjen e skemës finale (eliminimin e plotë të rasteve të mosplotësimit të kriterit N-1 nga rrjeti në zonë) nevojitet të shihet mundësia e fuqizimit të një ose disa prej segmenteve 110 kV më sipër me qark të dyfishtë me përcjellës ACSR 2x240/40 mm².

Skema finale

Duke u nisur nga niveli i ngarkimit të linjave 110 kV në zonë për skemën normale dhe mosplotësimit të kriterit N-1 në rast stakimi të linjës 110 kV Fier-Kafaraj, varianti më i mundshëm i skemës finale është menduar pikërisht:

- ▶ fuqizimi me dy qarqe i linjës 110 kV Fier-Kafaraj, që shfaqet si segmenti më i ngarkuar për shkak të distancës së afërt dhe orientimit të flukseve të fuqisë drejt Nst 400/220/110 kV Fier (Fier-Kafaraj është gjithashtu segmenti më i shkurtër i traktit 110 kV Fier-Babicë).

Nga analiza e kontigjencave rezulton se kjo skemë e plotëson tashmë kriterin N-1. Megjithatë i njëjti rezultat përftohet në alternativë dhe nga fuqizimi i linjës 110 kV Babicë-Selenicë.

Për të krijuar siguri për vlefshmërinë e këtij varianti kundrejt projeksioneve më afatgjata të rritjes së burimeve PV në zonë dhe me qëllim testimin e sigurisë së rrjetit në kushte më të vështira operimi për të identifikuar më mirë problematikat e tij, do të realizohet edhe simulimi i një skenari shtesë gjenerimi.

Duke e konsideruar skenarin bazë të mësipërm si skenari “konservator”, në këtë skenar më optimist do të konsiderohet lidhja e burimeve PV me kapacitet gjenerues 150 MW në Nst Kafaraj dhe 100 MW në Nst Vlora1. Shpërndarja e burimeve të tjera PV në zonë do të jetë e njëjtë si skenari i parë.

Skenari PV optimist

Nga simulimi i skenarit më optimist për rritjen e burimeve fotovoltaike për të njëjtin regjim operimi (piku i ngarkesës së verës), për skemën me linjat 110 kV Lushnjë-Kavajë dhe Fier-Kafaraj-Vlora1-Babicë të fuqizuara me një qark rezulton shpërndarja e flukseve të fuqisë për skemën normale të operimit si më poshtë:




Fig. 2 Skema me fuqizimin e linjave 110 kV Fier-Kafaraj-Vlora1-Babicë dhe 110 kV Lushnjë-Kavajë (skenari PV optimist)

Për këtë skenar rezulton se linja 110 kV Fier-Kafaraj ngarkohet plotësisht në nivelin 99% të kapacitetit transmetues (123 MVA). Gjithashtu nga analiza e kontigjencave rezultojnë mbingarkimet e elementeve si më poshtë:

Tab 2 Tabela përmblledhëse e kontigjencave për skenarin me fuqizim të plotë dhe lidhje të centraleve PV

Kontigjenca	Elementi i monitoruar	Ngarkimi (%)	Kapaciteti (MVA)
Skema baze	110 kV Fier - Kafaraj	98.9	123
110 kV Fier - Kafaraj	110 kV Kafaraj - Vlora1	98.1	123
	110 kV Vlora1 - Babice	147.9	123
	110 kV Babice - Selenice	139.2	64
220 kV Fier - Babice	110 kV Fier - Kafaraj	114.3	123
110 kV Vlora1 - Babice	110 kV Fier - Kafaraj	146.6	123

Duke analizuar kriterin N-1 për variantin final të propozuar (me linjën 110 kV Fier-Kafaraj me dy qarqe), rezulton se skema finale e plotëson kriterin e sigurisë N-1 edhe për këtë skenar më optimist gjenerimi, duke eliminuar plotësisht mbingarkimet e paraqitura në tabelë.

Kontigjenca që kufizon rritjen e mëtejshme të gjenerimit në zonë për këtë skemë është pikërisht stakimi i një qarku të linjës 110 kV Fier-Kafaraj që ngarkon plotësisht qarkun tjetër (por që nuk eliminohet si problematikë nga prezenca e qarkut të dytë në segmentet e tjera të traktit 110 kV Fier-Babice).

Konkluzione

Shpërndarja e flukseve të fuqisë për skemën finale të rrjetit, për skenarin e parë “konservator” të gjenerimit nga burimet PV në regjimin normal të operimit (pa stakime) është si më poshtë:




Fig. 3 Skema me fuqizimin e linjave 110 kV Fier-Kafaraj (dy qarqe), 110 kV Kafaraj-Vlora1-Babice dhe 110 kV Lushnjë-Kavajë (humbjet aktive = 50.9 MW)

Nga krahasimi i rezultateve të simulimeve të rrjetit për skemën bazë pa fuqizime kundrejt skemës finale të konceptuar vërehet **reduktimi i humbjeve të fuqisë aktive** në sistem nga 53.7 MW në 50.9 MW për regjimin operativ të ngarkesës pik të verës. Edhe në regjimin e ngarkesës pik të dimrit shfaqet një reduktim i lehtë i humbjeve aktive nga vlera 31.4 MW në 31.1 MW për skemën finale të fuqizuar. Lidhur me nivelet e tensioneve në nyjat 110 kV të rrjetit në zonë, në skemën bazë pa fuqizime shfaqet një profil relativisht i thyer i tensioneve. Në skemën finale të konceptuar, profili i tensioneve është më uniform përgjatë traktit 110 kV Rrashbull-Fier dhe Fier-Babice. Vlerat e tensioneve janë brenda

brezitet të lejuar të operimit, ndikuar dhe nga prezenca e shunt-reaktorit në Nst 400 kV Fier në modelin perspektiv të rrjetit. Më poshtë jepet grafikisht impakti i skemës finale në profilin e tensioneve:




Fig. 4 Krahasimi i niveleve të tensionit për nyjet kryesore për skemën aktuale dhe të fuqizuar përfundimtare

Përfundimisht nga arsyetimet e mësipërme rezulton se:

- Skema finale e fuqizimit konsiston në këto projekte:
 - Fuqizimi i linjës 110 kV Lushnjë-Kavajë me shtyllëzim dopjo qark dhe shtrirje përcjellësi me një qark me përcjellës ACSR 240/40 mm² (38 km)
 - Fuqizimi i linjës 110 kV Fier-Kafaraj me dy qarqe me përcjellës ACSR 2x240/40 mm² (9 km)
 - Fuqizimi i linjës 110 kV Kafaraj-Vlora1-Babicë me shtyllëzim dopjo qark dhe shtrirje përcjellësi me një qark ACSR 240/40 mm² (18.5 dhe 15 km)
- Skema finale e konceptuar plotëson kriterin e sigurisë N-1 për rrjetin 110 kV në zonë kundrejt projeksioneve afatgjata të zhvillimit të burimeve PV.
- Vlen të theksohet se për këtë nivel zhvillimi të burimeve fotovoltaike në zonë, rrjeti 220/400 kV mund të ketë nevojë për ndërhyrje të tjera për ruajtjen e sigurisë së operimit (jo subjekt i këtij relacioni).

FUQIZIMI I LINJAVE 110 KV FIER-KAFARAJ-VLORA1-BABICË

Nisur nga kapaciteti më i ulët transmetues prej vetëm 64 MVA dhe nga rezultatet e analizës N-1, rezulton se trakti 110 kV Fier-Kafaraj-Vlora1-Babicë përbën hallkën më të dobët të rrjetit 110 kV në zonë dhe rrjedhimisht kandidatin kryesor për fuqizim. Më poshtë paraqitet shpërndarja e flukseve të fuqisë për skemën me linjën 110 kV Fier-Kafaraj-Vlora1-Babicë të fuqizuar me përcjellës ACSR 240/40 mm², me kapacitet transmetues prej 123 MVA.




Fig. 5 Skema me fuqizimin e linjave 110 kV Fier-Kafaraj-Vlora1-Babicë

Rezultatet e analizës së kontigjencave N-1 për këtë skemë paraqiten në tabelë:

Tab 3 Tabela përmbledhëse e kontigjencave për skenarin me fuqizim Fier-Kafaraj-Florë-Babice.

Kontigjenca	Elementi i monitoruar	Ngarkimi (%)	Kapaciteti (MVA)
220 kV Elbasan1 - Fier	110 kV Kavaje - Lushnje	96.9	73
220 kV Rrashbull - Fier	110 kV Kavaje - Lushnje	98.4	73
110 kV Kuçovë - Marinëz	110 kV Kavaje - Lushnje	90.9	73
110 kV Fier - Kafaraj	110 kV Babice - Selenice	92.4	64
AT 400/220 kV Fier	110 kV Kavaje - Lushnje	119.5	73

Këto rezultate janë indikatorë të faktit që nevojiten ndërhyrje të mëtejshme në rrjet për integrimin në mënyrë të sigurt të burimeve fotovoltaike në zonë.


FURNIZIMI I NËNSTACIONIT ZOGU I ZI ME TENSION 110 KV

Në kuadër të komunikimit periodik dhe bashkëpunimit mes operatorëve të rrjetit të transmetimit dhe rrjetit të shpërndarjes, me qëllim bashkërendimin e investimeve në asetet përkatëse për të siguruar ndërhyrje efektive dhe optimale për zhvillimin e rrjetit, me shkresën Nr. 1538 Prot. Dt. 15.03.2023, OSSH sh.a. ka dërguar në OST sh.a. planifikimin e investimeve për N/Stacionet e OSSH sh.a. dhe zhvillimit të planifikuar të rrjetit të shpërndarjes.

Zhvillimi i ngarkesës së transformatorëve të fuqisë 110/20 kV të nënstacioneve të shpërndarjes në rajonin e Tiranës, është i lidhur ngushtë me planin zhvillimor të ngarkesës dhe të rrjetit 20 kV të qytetit të Tiranës. Në këtë mënyrë, synohet gradualisht kalimi i furnizimit të rrjetit shpërndarës 6 dhe 10 kV në nivel tensioni 20 kV, duke sjellë rrjedhimisht dhe reduktimin e niveleve të ngarkimit të elementeve të rrjetit 35 kV, përfshirë dhe transformatorët e fuqisë ekzistues. Shpërndarja optimale e ngarkesës në nënstacionet e shpërndarjes, në rajonin Tiranë, i shërben drejtpërdrejt menaxhimit më optimal të flukseve të fuqisë në rrjetin 110 kV unazor të qytetit të Tiranës.

Për qytetin e Tiranës, për periudhën 2023 – 2024, planifikohet investimi me objekt “Fuqizimi N/Stacionit 110/20 kV Zogu i Zi (2 x 40) MVA”. Në bazë të planit të zhvillimit dhe gjëndjes së rrjetit 110 kV, planifikohet që ky nënstacion të furnizohet nga linja e re kabllore 110 kV Tirana 1 – N/stacioni Qendër, duke çarë linjën kabllore 110 kV që planifikohet të ndërtohet me qëllim rezervimin e N/stacionit Qendër.

Per shkak se, periudha e planifikuar për ndërtimin e kësaj linje, është në varësi të ndërtimit dhe ecurisë së punimeve nga ana e OSSH sh.a. për N/Stacionin Zogu i Zi, ky projekt rekomandohet të mbahet i vecantë dhe i shkëputur nga linja 110 kV Tirana 1 – Qendër.



SLD e propozuar pas realizimit të projektit

Segmenti i ri i linjës 110 kV do të ndërtohet me të njëjtin seksion përcjellësi që do të ndërtohet linja e re kabllore 110 kV Tirana 1 - Qendër.

Shqipëria ka një potencial të konsiderueshëm të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë (BRE) dhe përdorimi i këtyre burimeve për prodhimin e energjisë mbështet objektivin afatgjatë të politikave energjetike të vendit, duke përfshirë mbështetjen për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, rritjen e sigurisë së furnizimit me energji dhe mbrojtjen e Mjedisit. Përdorimi i energjisë së rinovueshme mund të ndihmojë në uljen e varësisë nga importet e energjisë dhe përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji, madje mund të ndihmojë në sigurinë makroekonomike dhe politike të vendit.

Kompania OST, ka përjetuar veçanërisht gjatë dy viteve të fundit një intensitet të lartë të aplikimeve për lidhje të centraleve fotovoltaike të përqendruara jo vetëm në rajonin e ultësirës perëndimore përkatësisht në Fier, Vlorë dhe Lushnje por dhe në rajonin qendror si në Elbasan, Belsh, Kajan por dhe në rajonin juglindor të vendit kryesisht në Ersekë.

Sipas strategjisë Kombëtare të Energjisë 2018+2033 një nga objektivat e vendit është që Targeti i energjive të rinovueshme kundrejt konsumit total të arrijë në nivelin 42% në vitin 2030.¹

Të favorizuar nga pozicioni gjeografik i zonës Fier, Vlorë dhe vlerave relativisht të larta të orëve vjetore me rrezatim diellor të konsiderueshëm, është shtuar ndjeshëm interesi i investitorëve në ndërtimin e parqeve fotovoltaike për gjenerimin e energjisë elektrike në këtë zonë.

Kjo situatë është reflektuar në faktin se gjatë dy viteve të fundit ka patur një numër të lartë të aplikimeve për lidhje të centraleve fotovoltaike në rrjetin e transmetimit në rajonin Lushnjë-Fier-Vlorë. Zona e Fierit, së bashku me zonën e Spitallës në Bashkinë Durrës është shpallur zonë me potencial të lartë të rrezatimit diellor nga MIE duke qenë një zonë prioritare për përmbushjen e politikës së diversifikimit të burimeve energjetike në vend.

Në vijim të ankandit për ndërtimin e një parku fotovoltaik në zonën e Spitallës e shpallur si një zonë me potencial të lartë diellor, është përcaktuar kompania fituese e cila do të ndërtojë një central fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100MW brenda një të ardhme të afërt, i cili planifikohet të lidhet në anën 110kV të Nstacionit Porto Romano (Spitallë).

N/stacioni Porto Romano ka të instaluar dy transformatorë fuqie 2x25 MVA me nivele tensioni 110/20 kV. Fiderat dalës 20 kV furnizojnë përveç konsumatorë familjarë dhe biznese edhe konsumator të rëndësishëm si spitali, universitetin e Durrësit, pjesë të Portit dhe të depozitave të vendosura në zonën Rinia.

Referuar pozicionit gjeografik të nënstacionit P.Romano dhe kompozimit të rrjetit të transmetimit në këtë zonë, ekziston mundësia e ndërtimit të një linje të re 110kV për tu lidhur me nënstacionin e Gjirit të Lalzit me gjatësi 20 km me përcjellës ACSR-240mm².

Realizimi i kësaj linje do të sjellë operimin në unazë të të dy nënstacioneve si nënstacioni P.Romano dhe nënstacionit të Gjiri i Lalzit të cilat aktualisht punojnë të lidhur me linja radiale pa mundësi rezervimi nga një burim i dytë energjie.




Fig. 6 Vendndihja gjeografike e nënstacioneve P.Romano (Spitallë) dhe Gjiri Lalzit

¹ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/07/31/480>




Fig. 7 Skema elektrike e lidhjes së nënstacioneve P. Romano dhe Gj. Lalezit me rrjetin e transmetimit

N/STACIONI 110/20 KV SPITALLE (P.ROMANO)




Fig. 8 Skema elektrike unipolare e nënstacionit P. Romano

9 Skema elektrike e lidhjes së nënstacioneve P. Romano dhe Gj. Lalezit me rrjetin e transmetimit

Ndërtimi i N/stacionit të Gjirit të Lalzit 110/20kV u realizua nga operatori i shpërndarjes OSHEE sh.a dhe në kuadër të bashkëpunimit të dyanshëm, nga ana e OST u ndërtua linja 110kV nënstationi Sallmone- Gjiri i Lalzit si dhe një shtesë trakti në N/stacionin Sallmone e cila u vu në operim në vitin 2020.

Për vetë rëndësinë që ka operimi i N/stacionit Gjiri i Lalzit është e nevojshme furnizimi i tij me një linjë të dytë për të përmbushur kriterin e sigurisë statike N-1 dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike.




Fig. 10 Skema elektrike unipolare e nënstationit Gj.Lalzit

Nënstationi i Gjirit të Lalzit është i pozicionuar në zonën e Ishëmit i cili është pjesë administrative e Qarkut Durrës dhe ndodhet në veri të territorit të tij ku ndahet qartë (si territor) nga lumi Ishëm në veri dhe nga Përroi i Tarinit në jug. Ka një sipërfaqe totale prej 8,000 ha duke u kufizuar në juglindje me komunën e Prezës, në perëndim me detin Adriatik dhe Bashkinë Manez , në lindje me komunën Thumanë të rrethit të Krujës.

Vija bregdetare e Komunës së Ishmit, laget nga deti Adriatik dhe shtrihet nga kufiri Jugor me Bashkinë Durrës e deri në kufirin verior me Bashkinë e Lezhës. Ai ka një vijë bregdetare afërsisht 25 km, ku përfshihen Gjiri i Lalzës dhe Gjiri i Ramshpatit. Bregdeti është i ndarë në dy pjesë ne atë që quhet Plazhi i Shën Pjetrit në formën e një gjysmë unaze dhe që identifikohet si Gjiu i Lalzit që përfundon në anën veriore të tij me kepin e Rodonit Numri i banorëve të komunës së Ishmit është 8,622, nga të cilët 4,352 janë meshkuj dhe 4,270 janë femra. Janë rreth 2,229 familje. Tre janë aktivitet kryesore ekonomike që zhvillohen në rajonin e Ishmit. Së pari është aktiviteti i shërbimeve turistike, së dyti blegtoaria dhe së treti bujqësia e mbështetur tek frutikultura.

Karakteristike e bizneseve në zonë është biznes i vogël i cili zë 99 % të numrit total te bizneseve, ndërsa vetëm 1% është regjistruar si biznes i madh me aktivitet prodhim inertesh dhe një pulari. Ky specifikim i bizneseve sipas madhësisë është i njëjte ne tendence me zhvillimin e biznesit ne Shqipëri (ne Shqipëri 99 % e biznesit hyn ne biznes te vogël). Pjesën më të madhe të numrit të punonjësve të siguar janë të punësuar në sektorin e shërbimeve.

Një nga drejtimit më të përshtatshme të zhvillimit të ardhshëm ekonomik është turizmi. Turizmi si sektor ofron mundësinë e arritjes së objektivave të zhvillimit në mënyrë të natyrshme, duke plotësuar dhe shumëzuar edhe zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë. Zhvillimi i sektorit të turizmit në

zonë do të rrisë kërkesën edhe për prodhimet bujqësore e blegtorale, transportet, dhe shërbime të tjera. Gjithashtu, zhvillimi i turizmit do të rigjallëroje zonën edhe nëpërmjet krijimit të mundësive të reja të punësimit në facilitetet turistike, si edhe angazhimin në struktura familjare priteje vizitueshëm. Numri në rritje i vazhdueshëm i vizitueshëm, ndikimi i turizmit dhe shprehja e interesit privat të vazhdueshëm, e shprehur në formën e investimeve në hotele dhe objekte rekreative, si dhe interesimi i qeverisjes vendore, të shprehur në formën e një vëmendje të veçantë në planet e zhvillimit lokal në planifikimin dhe çështjeve investimeve që lidhen me turizmin, vërtetojnë se zhvillimi i turizmit është një mjet kyç për zhvillim të vendit. Afërsia me qendrat urbane tregon se praktikisht Ishmi gjendet brenda zonës së gjerë funksionale urbanistike të zonës metropolitane, që do të thotë që dikush mund të jetojë praktikisht në Durrës ose Tiranë dhe të udhëtoje në Ishem për të punuar në baza ditore. Në mënyrë të ngjashme ky është rasti për vizitorët ditore që aktualisht përfaqësojnë pjesën më të madhe të aktivitetit të turizmit.

Analizat teknike të rrjetit

Me qëllim analizën teknike të nevojës dhe impaktit të ndërtimit të linjës së re 110 kV Gj.Lalëzit-P.Romano do të shfrytëzohet modeli perspektiv i rrjetit të transmetimit për dy regjime të ndryshme operimi, në të cilat pritet të evidentohet më qartë nevoja për këtë projekt. Nisur nga karakteristikat dhe konfigurimi i rrjetit në rajonin e Durrësit, si një zonë me përqendrim të lartë të kërkesës për energji elektrike dhe rrjedhimisht një nga qendrat kryesore të ngarkesës në sistem, do të analizohet fillimisht regjimi i ngarkesës pik të dimrit (që korrespondon me ngarkesën pik të vitit).

Gjithashtu duke marrë shkas nga zhvillimi i turizmit, ky rajon paraqet një ngarkesë të theksuar dhe në sezonin veror, të krahasueshme me ngarkesën mesatare gjatë dimrit. Për këtë arsye do të merret në analizë dhe regjimi i ngarkesës pik të verës. Ky regjim përkon njëkohësisht dhe me orët e vitit ku pritet gjenerimi maksimal nga burimet fotovoltaike, prandaj shërben për të konsideruar dhe impaktin e plotë të flukseve të gjeneruara nga lidhja e parkut fotovoltaike Spitallë në nënstationin 110 kV Porto Romano.

Regjimi pik dimër

Shpërndarja e flukseve të fuqisë në rrjetin e zonës paraqitet në figurën më poshtë. Ky regjim përkon me vlerat më të larta të ngarkesave të Nst 110 kV Sukth, Gj.Lalëzit dhe P.Romano. Kapaciteti transmetues prej 123 MVA i linjës 110 kV Rrashbull – P.Romano dhe linjave 110 kV Rrashbull - Sukth - Gj.Lalëzit është i mjaftueshëm për furnizimin e këtyre nënstationeve në skemën bazë.




Fig. 11 Skema bazë në regjimin pik dimër (thumbjet aktive = 30.5 MW)

Nga analiza e kontigjencave rezulton se rrjeti në këtë rajon dukshëm nuk e plotëson kriterin e sigurisë statike N-1 për rastet e stakimit të linjave radiale 110 kV Rrashbull – P.Romano dhe 110 kV Rrashbull - Sukth - Gj.Lalëzit. Stakimi i secilës prej linjave 110 kV më sipër pamundëson furnizimin e N.stacioneve të lidhura në mënyrë radiale me rrjetin dhe rrjedhimisht shoqërohet me energji të mosfurnizuar për këta konsumatorë. Në tabelën në vijim jepen në mënyrë më të detajuar rezultatet e analizës N-1 për këtë regjim:

Tab 4 Tabela përmblledhëse e kontigjencave për skenarin bazë në regjimin pik dimër.

Regjimi i pikut të dimrit	Kerkesa/gjenerimi i mosfurnizuar (MW)				
	Ngarkesa			Gjenerimi	Total
Linja që stakohet	Nst Sukth	Nst Gj.Lalëzit	Nst P.Romano	PV Spitalle	(MW)
110 kV Rrashbull - P.Romano			50.7		50.7
110 kV Rrashbull - Sukth	32.3	6.9			39.2
110 kV Sukth - Gj.Lalëzit		6.9			6.9

Ndërtimi i linjës së re 110 kV Gj.Lalëzit-P.Romano mundëson eliminimin plotësisht të kontigjencave të mësipërme duke sjellë plotësimin e kriterit N-1. Në figurë jepet dhe shpërndarja e flukseve të fuqisë për rrjetin e zonës.




Fig. 12 Skema me linjën 110 kV Gj.Lalëzit-P.Romano në regjimin pik të dimrit

(thumbjet aktive = 30.5 MW)

Regjimi pik verë

Regjimi i pikut të verës karakterizohet nga ngarkesa relativisht të larta në nënstationet e rajonit të Durrësit. Për më tepër, në këtë regjim është marrë në konsideratë gjenerimi maksimal nga parku fotovoltaik Spitalle me kapacitet të instaluar 100 MWp, i lidhur në Nst 110 kV P.Romano. Shpërndarja e flukseve të fuqisë në rrjetin e zonës paraqitet në figurën më poshtë:




Fig. 13 Skema bazë në regjimin pik verë (thumbjet aktive = 61 MW)

Linja e re:

- nuk shfaq impakt të ndjeshëm në profilin e tensionit në këto nënstacione 110 kV
- mundëson një reduktim të lehtë të humbjeve të fuqisë aktive në sistem për regjimet e ngarkesës së verës,
- por impaktin kryesor të saj e shfaq në rritjen e theksuar të sigurisë së furnizimit në zonë, duke reduktuar plotësisht energjinë e mosfurnizuar konsumatorëve dhe kufizimin e energjisë së gjeneruar nga parku PV.

INSTALIMI I QARKUT 110 KV NE LINJEN EKZISTUESE BUSHAT - VELIPOJE

Ndërtimi i linjës 110 kV Kufi - Velipojë, është pjesë e linjës së re që është ideuar të ndërtohet, dhe që do të lidhe N/St e Ulqinit (Mali i Zi) me N/St. e Velipojës (Shqipëri). Ky segment është pjesë e linjës së re Ulqin (Mali i Zi) - Velipojë (Shqipëri) 110 kV, i cili do të vazhdojë më tej në linjën ekzistuese Velipojë - Bushat, ku do të bëhet edhe lidhja e kësaj linje. Pjesa e linjës N/St. Velipojë - Bushat që shtrihet në territorin shqiptar është një segment i ndërtuar me shtyllëzim, për një rrjet 110kV, çka krijon mundësinë praktike për shfrytëzimin e saj, dhe mundëson konkretisht në këtë rast, që të vijohet të shtrohet qarku i dytë me të gjithë elementet e tij për nivelin e tensionit 110 kV nga Velipoja në N/St. e Bushatit.


Zonat e Ulqinit dhe Velipojës, siç dihet, janë dy zona me potencial shumë të madh turistik, dhe sigurimi i infrastrukturës energjetike, do të garantonte ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm turistik të zonave në fjalë.

NDERTIMI I LINJES KABLLORE ME DY QARQE 110 KV RRASHBULL-SHKOZET, RRETH 2 KM

Nënstacioni i Shkozetit është nënstacioni kryesor që furnizon me energji elektrike qytetin dhe zonën turistike të bregut të detit Durrësit.

Nënstacioni i Shkozetit furnizohet nga nënstacioni i Rrashbullit me dy linja 110 kV, 1.5 km dhe 1.7 km respektivisht secila, me përcjellës AC-120 mm². Linjat janë të ndërtuara në vitin 1960, janë të amortizuara dhe kapaciteti i tyre transmetues është mjaft i kufizuar. Përveç kësaj, stakimi i njëjës prej tyre mbingarkon tjetrën duke mos plotësuar kriterin e sigurisë N-1.

Zona është plotësisht e populluar dhe gjetja e një korridorit për rikonstruksionin e linjave ekzistuese sipas standardeve të përdorura nga OST, del e pamundur. Për këtë është parashikuar ndërtimi i linjave kablore 110 kV me dy qarqe me përcjellës XLPE AL-1,000 mm², dhe ky projekt do të përmbajë përveç terminaleve, shkarkueseve dhe xhuntove edhe instalimin e fibrës optike kablore nëntokësorë për të mundësuar shkëmbimin e të dhënave në kohe reale për monitorimin dhe kontrollin e elementeve komutues të nënstacionit Shkozet.



RIKONSTRUKSION I LINJES 110 KV LAC 1 - FUSH KUQE DHE TRAKTI PERKATES NE NST FUSH KUQE

Nënstacioni i Fushe Kuqes është nënstationi kryesor që furnizon me energji elektrike stacionin e pompimit të Fushe Kuqes. Ky Nënstation aktualisht furnizohet me linje radiale nga Nënstationi Laç 1, linje e cila është në gjendje teknike të keqe. Në Nst Fushe Kuqe linja nuk ka trakt të rregullt por lidhet me zbarat e këtij nënstationi me ane të një thike 110 kV.




Figura 3: Skema aktuale e furnizimit të nënstationit F. Kuqe.

Nëpërmjet ndërtimit të linjës 110 kV Gjiri Lalzit – F. Kuqe pritet që të rritet siguria e furnizimit të këtij nënstationi në mënyrë të ndjeshme. Me qëllim mbylljen e unazave në linjat 110 kV dhe përballimin e flukseve të energjisë është e nevojshme që gjithashtu të rikonstruohet dhe linja F. Kuqe – Laç 1 me linje tek qark me përcjellës ACSR 240/40mm², si dhe rikonstruksioni i traktit përkatës të linjës në nënstationin F. Kuqe.

NDERTIMI I LINJES SE RE 110 KV HEC LURE - SHUMAT SE BASHKU ME TRAKTET PERKATESE

Rrjeti elektrik në segmentet Fierzë – Fushë Arrëz – Kukës – Lapaj – Peshkopi – Bulqizë – Burrel përfaqëson një unazë 110 kV me një shtrirje në të gjithë zonën verilindore të vendit, në të cilën janë lidhur dhe janë në proces ndërtimi një numër i madh HEC-esh me fuqi të përgjithshme 281 MW.


Për të rritur kapacitetin transmetues, rritjen e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike të zonës nga ana e OST janë në proces zbatimi projektet :

- Ndërtimi i linjës së re 220 kV Burrel – Peshkopi dhe trakti dalës në N stacionin e Burrelit.
- Ndërtimit të nënstationit të ri 220/110/35 kV Shumat, dhe i traktit 220kV në Nënstationin e Burrelit.


Të dy investimet priten të sjellin një impakt të madh në reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike dhe përmirësimin e profilit të tensionit. Vënia në shfrytëzim e këtyre projekteve do të garantojë operimin optimal të burimeve hidrike të zonës dhe një furnizim cilësor për konsumatorët.

Në kuadër të fuqizimit të unazës verilindore dhe paralelisht me ndërtimin e nënstationit 220/110/35kV planifikohet realizimi i një linje 110kV me dy qarqe me gjatësi 23km e cila do të shërbejë për lidhjen e nënstacioneve të HEC Lurës dhe të anës 110kV të N stacionit të Shumatit.

Aktualisht nënstationi i HEC Lurës operon në mënyrë radiale dhe i lidhur me sistemin vetëm me linjën 110kV L-110-46 e cila përfundon në nënstationin e Kurbneshit i cili nga ana e tij është i lidhur me sistemin me anë të linjës 110kV L-110-3 e cila përfundon në anën 110kV të HEC Ulzë siç paraqitet në figurën e mëposhtme:



Skema e lidhjes së Nënstacioneve Kurbnesh dhe Shutri si dhe gjeneruesit e lidhur në këtë skemë




Linja e re 110kV Nstacioni HEC Lure- Shumat

Pra në këtë skemë janë të lidhur nënstationet Kurbnesh dhe Shutri si dhe gjeneruesit me fuqi totale 37 MW.

Furnizimi i nënstationeve nëpërmjet një linje radiale nënkupton se për këtë nënstation (apo nënstatione) nuk plotësohet kriteri N-1 i sigurisë statike që do të thotë se difektimi i linjës L-110-3 në dalje të nënstationit të HEC Ulzës do të linte pa furnizim nënstationet Kurbnesh dhe Shutri si dhe pa mundësi injektimi në rrjet të gjeneruesve të lidhur në skemë duke sjellë penalizime për Operatorin e OST në të ardhmen në kuadër të rregullores së cilësisë.

Ky projekt investimi, është rivendosur në programin e Investimeve për periudhën 2024-2027.

Nënstacioni 110 /6 kV F. Krujë është një nënstacion i ndërtuar rreth viteve 1970. Në këtë nënstacion terminojnë tre linja 110 kV, linja Tirana1-F.Krujë, Laç2- F. Krujë dhe linja 110 kV F. Krujë – Krujë (linje radiale). Ka të instaluar dy transformator fuqie 110/6 kV të cilët aktualisht janë 31.5 MVA dhe tjetri po 110/6 kV me fuqi 10 MVA . Ky nënstacion është i pozicionuar në veri të qytetit të F. Krujës në një zonë industriale pranë fabrikës së çimentos ku ambienti është i ngarkuar me pluhur. Skema njëpolare e këtij nënstacioni është si në figurën në vijim;



Skema njëpolare e nënstacionit 110/6kV te Fushë Krujës


Nga skema shihet se dy linjat 110 kV në drejtim të Tirana1 dhe të Laç 2 janë me thika ndërsa linja në drejtim të Krujës është me trakt të rregullt (kryer para 10 vjetësh). Theksojmë se gjëndja e pajisjeve primare është tejet e amortizuar, sikurse thamë edhe për shkak të kohës së gjatë të operimit dhe për shkak të ambientit të ndotur .

Prej shume vitesh çelësi seksionues është jashtë funksioni (i shuntuar), edhe elementet e tjerë dhe pajisjet komutuese janë tejet të amortizuara .


Sa i përket ngarkesës që ka si nënstacion vlen të theksohet se ka pasur një reduktim vitin e fundit pas ndërhyrjes së OSHEE e cila ka instaluar një nënstacion portabël i cili është lidhur në forme “T” në linjën 110 kV Tirana1-F.Krujë dhe ka të instaluar një transformator 110/20 kV me fuqi 25 MVA. Megjithatë ngarkesa e nënstacionit F. Krujë vijon të jetë relativisht e madhe .

Ngarkesat e këtij nënstacioni gjatë vitit 2019, janë pasqyruar në grafikun e mëposhtëm të ndarë sipas muajve (energja e konsumuar grafiku 1 dhe ngarkesa maksimale grafiku 2). Në këta grafike janë pasqyruar dy transformatorët e nënstacionit F. Krujë si dhe ngarkesa e nënstacionit Kruje i cili furnizohet radialisht nga zbarat 110 kV të nënstacionit F. Krujë.

Energjia Mujore per
2019 (MWh)



Grafiku 1 :Energjia e konsumuar nga ana 110 kV (F.Kruje+Kruje)




Grafiku 2 :Piku ngarkesës nga ana 110 kV (F.Kruje+Kruje)


Për shkak të ngarkesave të konsiderueshme të këtij nënstacioni, OST në vitin 2013 për të rritur kapacitetin e transmetimit të linjës 110 kV Tirana1-F.Krujë, investoi në ndërrimin total të përcjellësit të kësaj linje duke rritur seksionin e tij nga Al/Ç 120 mm² ne Al/Ç 150 mm²

Nga ana tjetër, nënstacioni 110 kV F. Krujë praktikisht furnizohet nga zbara 110 kV e nënstacionit 220/110/35/20 kV Tirana 1. Nënstacioni Tirana1 nga ana 110 kV (zbaren 110 kV) furnizohet me tre autotransformator 220/110/35 kV me fuqi 120 MVA. Ngarkesa e nënstacionit Tirana 1 nga ana 110 kV ne muajt e dimrit dhe veçanërisht në orët e pikut në këtë sezon është relativisht shumë e madhe dhe nga pikëpamja e fuqisë transformuese është e pa rezervuar .

Ngarkesat e autotransformatoreve në nënstacionit 220/110/35/20 kV Tirana1 gjatë vitit 2019 janë pasqyruar në grafiket e mëposhtëm të ndarë sipas muajve (energjia e konsumuar grafiku 3 dhe ngarkesa maksimale ne tre autotransformatorët 220/110/35 kV e matur nga ana 220 kV grafiku 4)



Grafiku 3 :Energjia e konsumuar nga ana 220 kV (AT1,AT2,AT3 ne Tirana1)



Grafiku 4 : Piku i ngarkesës nga ana 220 kV (AT1,AT2,AT3 ne Tirana1)

Nëse gjatë sezonit me ngarkesa të mëdha (sezonit të dimrit) do të dilte nga operimi njëri nga autotransformatorët 220/110/35 kV ashtu siç duket edhe nga grafiku i mësipërm, kjo do të kërkonte reduktim të ngarkesës së këtij nënstacioni (kufizime relativisht të mëdha të rendit ~ 40 MW).

Duhet patur parasysh që ngarkesa e zbarës 110 kV e nënstacionit Tirana 1 është shumë e vështirë të reduktohet pasi konsumatorët që furnizohen nga kjo zbarë, përjashtojnë nënstacionin F. Krujë, kryesisht janë qyteti i Tiranës dhe institucionet e rëndësishme të shtetit.

Zhvillimi i skemës në nënstacionin 110 /6 kV F. Krujë

Duke u nisur nga sa thamë më sipër, propozojmë që skema e nënstacionit 110/6 kV F. Krujë të zhvillohet, të zgjerohet duke u lidhur në nivelin 220 kV nëpërmjet një autotransformatori 220/110/20 kV.

Ajo çfarë në thelb përfshin zhvillimi i Nënstacionit 110/6 kV F.Kruje konsiston në instalimin e një autotransformatori me fuqi 90-120 MVA 220/110/20 kV.

Ky autotransformator nga ana 220 kV do të furnizohet nëpërmjet linjës së re e cila duhet të ndërtohet nga nënstacioni 220/6kV Fabrikës Çimentos F. Krujë deri tek Nënstacioni 110 /6 kV F. Krujë. Nga ana 110 kV do të lidhet me zbarat ekzistuese të Nënstacionit 110/6 kV F. Krujë.

Sigurisht për shkak të amortizimit të madh të pajisjeve është e nevojshme të bëhet edhe rikonstruksioni i zbarave 110 kV të këtij nënstacioni përfshi dhe ndërtimin e dy trakteve të reja 110 kV për linjat F. Krujë –Laç1 dhe F. Krujë –Tirana1.

Nënstacioni 220/6kV Fabrikës Çimentos F. Krujë fizikisht është i pozicionuar në një distance ~250 ml nga Nënstacioni 110 /6 kV F. Krujë. Ndërtimi i linjës së re 220 kV përfshin edhe ndërtimin e traktit 220 kV në nënstacionin 220/6 kV Fabrikës Çimentos.

Sa i përket zhvillimit të anës 220 kV në Nënstacion 110/6 kV F. Krujë, duke qenë se hapësirat e nënstacionit janë të kufizuara, propozojmë që të ndërtohet vetëm trakti i autotransformatorit nga ana 220 kV (pa trakt linje 220 kV), edhe për faktin se distanca (gjatësia e linjës 220 kV) është e vogël ~250 ml.

Linja e re 220 kV F. Çimento – F. Krujë mund të konsiderohet si “zgjatim” i zbarave 220 kV të nënstacionit 220/6 kV F. Çimento dhe në këtë sens nuk është i domosdoshëm ndërtimi i traktit 220 kV të kësaj linje në nënstacion F. Krujë .

Nga ana 110 kV do të ndërtohet një seksion i ri në zgjatim dhe në aks të seksioneve ekzistuese ku do të lidhet nga ana 110 kV me trakt të rregullt autotransformatori 90 MVA 220/110/20 kV.

Seksioni i ri 110 kV do të lidhet me seksionin ekzistues vetëm nëpërmjet një ndarësi (thike) 110 kV. Po ashtu, do të ketë edhe daljen 20 kV e cila mund të zhvillohet në të ardhmen me ndërtimin e impiantit 20 kV sipas kërkesës dhe nevojës së kompanisë së shpërndarjes OSSH.

Skema e nënstacionit F. Krujë pas ndërhyrjes për zhvillimin dhe rikonstruksionin e tij do të jetë si në Figurën 2 në vijim:




Fig2 . Skema njëpolare e nënstacionit 110/6 kV F. Krujë pas zhvillimit

Ashtu sikundër u tha më lart, hapësirat për të zhvilluar skemën janë të kufizuara prandaj traktet e autotransformatorit si nga ana 220 kV dhe ana 110 kV do të jenë me pajisje të integruara HGIS, ndërsa rikonstruksioni, ndërtimi i dy trakteve të linjave 110 kV F. Krujë –Laç1 dhe F.Kruje –Tirana1 si dhe seksionuesi 110 kV mund të ndërtohen me pajisje klasike pasi kanë hapësirën e nevojshme.

Vendosja e këtij autotransformatori 90-120 MVA 220/110/20 kV në nënstationin e F. Krujës e rrit shumë fleksibilitetin e skemës 110 kV të këtij rajoni pasi krijon mundësinë e injektimit të energjisë në këtë pjesë të rrjetit 110 kV, duke rezervuar deri në 60 MË (kapaciteti i linjës 110 kV F. Krujë – Tirana1) për zbarën 110 kV të nënstationit Tirana 1. Po ashtu, rezervon furnizimin e një konsumatori të rëndësishëm siç është Fabrika e çimentos F. Krujë e cila aktualisht furnizohet në mënyre radiale nga linja 220 kV nga Nënstacioni Antea Çimento –F. Çimento. Avantazhi që sjell ky zhvillim i skemës duket qartë nga skema e treguar në fig. 3 ne vijim .




Fig3 . Unazimi i nënstationit F. Krujë me rrjetin 220 kV

Lidhur me implementimin e këtij projekti, si për zhvillimin e skemës ashtu edhe rikonstruksionit të trakteve 110 kV, nuk parashikohet ndonjë problem sa i përket operimit të nënstacionit 110/6 kV F. Krujë. Pjesa që do të zhvillohet është planifikuar të ndërtohet në një shesh të lirë që ekziston brenda rrethimit të nënstacionit, ndërsa rikonstruksioni i trakteve 110 kV do të realizohet si në të gjithë nënstacionet e tjerë, trakt pas trakti duke shmangur ndërprerjet për intervale të gjata të furnizimit me energji të konsumatorëve që furnizohen nga ky nënstacion.

Në nënstacionin 220/6 kV F. Çimento, ekziston vendi për ndërtimin e daljes së linjës së re 220 kV F. Çimento- F. Krujë.

Në foton në vijim tregohet një pamje nga lart e nënstacionit F. Krujë 110 kV dhe nënstacionit 220 /6 kV F. Çimento dhe gjurmës së linjës së re që duhet ndërtuar .



Pamja e nënstacionit F. Kruje dhe F. Çimento

Zërat kryesorë të punimeve që parashikohen të kryhen për realizimin e këtij projekti (furnizim-vendosje), të ndarë sipas fazave:

Punime për fazën e parë

- 1- Ndërtimi i traktit 220 kV në nënstacion F. Çimento
- 2- Ndërtimi i linjës së re 220 kV F.Çimento-F.Kruje (gjatësia ~250 ml)
- 3- Ndërtimi i bazamentit të Autotransformatorit
- 4- Blerja dhe instalimi i një autotransformatori 90-120 MVA
- 5- Ndërtimi i traktit 110 kV i autotransformatorit në N/st F. Krujë

Punime për nje fazë të dytë

- 1- Rikonstruksioni i tre trakteve dhe zbarave 110 kV të N/st F. Krujë
- 2- Punime për rikonstruksionin e godinës

Disa nga avantazhet kryesore që sjell ky investim janë:


- Përmirëson cilësinë e furnizimit duke siguruar rezervim për konsumatorët e rajonit të F. Krujës, Krujës, Laçit dhe konsumatorëve që furnizohen nga zbara 110 kV e nënstationit Tirana1. Rezervon furnizimin e Fabrikës së Çimentos.
- Vendosja e një autotransformatori (nëpërmjet RAT) do të bëjë të mundur dhe rregullimin e profilit të tensioneve në rrjetin 110 kV të këtij rajoni .
- Nëpërmjet rikonstruksionit të trakteve dhe zbarave 110 kV do të rritet siguria e furnizimit të konsumatorëve që furnizohen nga N/st F. Krujë.
- Rritet shumë “fleksibiliteti” i skemës nga ana 110 kV.

Krijon mundësinë për zhvillimin në perspektivë të rrjetit 20 kV në rajonin e F. Krujës.

NDERTIMI I NJE SEGMENTI TE RI LINJE 110 KV PER TE ANASHKALUAR QYTETIN E GJIROKASTRES

Zhvillimi i zonave urbane ne përgjithësi ne territor ka bere qe linjat e transmetimit ne disa qytete te përfshihen ne zonat urbane te tyre duke krijuar ne shume raste problematika ne lidhje me distancat ndërmjet linjave dhe objekteve. Ne nje shtate te tille është linja 110 kV qe lidhe N/ST Gjirokastër e re me NST Gjirokastër e vjetër si dhe vijimi i kësaj linje ne drejtim te Sarandës.

Ne këtë projekt synohet zhvendosja e linjës 110 kV ne segmentin rreth qytetit te Gjirokastrës me qellim shmangien e zonave me ndërtime. Nga vlerësimet paraprake synohet te ndërtohet një segment i ri linje me gjatësi rreth 7 km. Segmenti i ri i linjës 110 kV do te ndërtohet me përcjellës ACSR 240/40mm² ne zbatim te politikave te kompanisë.



RIKONSTRUKSION I TRAKTEVE TE LINJES DHE SISTEMIT TE ZBARRAVE TE N/ST BALLSH

NDERTIMI I SISTEMIT TE RI TE ZBARRAVE 110 KV NE N/ST KAFARAJ DHE 3 TRAKTE TE REJA LINJE

RIKONSTRUKSION I TRAKTEVE TE NENSTACIONIT ERSEKE DHE REALIZIMI I SKEMES HYRJE DALEJ NE KETE NST

DY TRAKTE TE REJA 110 KV HYRJE-DALJE NE NST E DRENOVES

DY TRAKTE TE REJA 110 KV HYRJE-DALJE NE NST E KRAHESIT

DY TRAKTE TE REJA 110 KV HYRJE-DALJE NE NST E KELCYRES

DY TRAKTE TE REJA 110 KV HYRJE-DALJE NE NST E GJIROKASTRES SE VJETER

Nëpërmjet këtyre projekteve synohet rikonstruksioni i trakteve të linjave dhe sistemit të zbarave në një sërë nënstacionet të cilët kanë nevojë për ndërhyrje për shkak të gjendjes së tyre fizike dhe fleksibilitetit të skemës.


Këto nënstacione kryesisht janë të lidhur në rrjetin 110 kV në formë T dhe lidhen me sistemin e zbarave të nënstacionit nëpërmjet vetëm një ndarësi 110 kV. Në këtë situatë është nënstacioni Krahës, ndërsa nënstacionet si ai i Drenovës është i lidhur me rrjetin nëpërmjet skemës hyrje dalje në nënstacion por gjithashtu dhe në këtë nënstacion traktet e linjës janë të përberë vetëm nga një ndarës 110 kV.

Nëpërmjet këtij projekti synohet ndërtimi i skemave klasike Hyrje – Dalje në nënstacionet që preken si dhe ndërtimi i një sistemi të ri zbarash 110 kV të ndarë minimalisht në 2 seksione.

QARKU I DYTE I LINJES 110 KV VLORA 2 – BABICE

Aktualisht nënstacioni Vlora 2 është i lidhur me nënstacionin Babicë në mënyrë radiale nëpërmjet linjës 110 kV Babicë – NST Vlora 2.

Nëpërmjet këtij projekti synohet ndërtimi i qarkut të dytë të kësaj linje duke theksuar faktin se trakti i linjës në nënstacionin Vlora 2 është aktualisht i ndërtuar. Duke parë pozicionin gjeografik të linjës dhe situatën e banesave në afërsi të nënstacionit propozohet që segmenti i parë i linjës 110 kV të ndërtohet kabllorë dhe me pas vijimi të jetë ajrore me linje me një qark me përcjellës ACSR 240/40 mm².



RIKONSTRUKSIONI N/ST 220/110/35 KV SHARRE, FAZA 2

Aktualisht për Nënstacionin 220/110/35kV Sharre është lidhur kontrata për instalimin e një Autotransformatori te dyte 220/110 kV si dhe rikonstruksioni i pjesshëm i sistemit te zbarave 220 dhe 110 kV, si dhe ndërtimi i një ndërtesë te re kontrolli.

Nëpërmjet këtij projekti synohet finalizimi i ndërhyrjeve ne kete NST dhe ndërtimi i pjesës se mbetur te sistemit te zbarave 220 kV, traktit te linjës dhe transformatorit se bashku me seksionues 220 kV.

FURNIZIM VENDOSJE E 1 FAZE TE AUTOTRANSFORMATORIT 400/220 KV 115 MVA KOMAN SI DHE RIPARIMI I FAZES "C" TE AT 400/220 KV 115MVA KOMAN

Në datën 21.10.2023 u stakua në avari AT-3x115 MVA, 410/230 kV i Nënstacionit Koman, si rrjedhojë ky Nënstacion doli plotëisht jasht shërbimi.

Shkak i stakimit ishte veprimi i mbrojtjeve teknologjike të Fazës A të AT-3x115 MVA, 410/230 kV. Nga ana e DSHMT/SIMPP u morën masat urgjente për verifikimin e shkaqeve të avarisë dhe u kryen tetimet e plota. Pas kryerjes së testeve, mbi bazën e rezultateve të marra u hartua relacioni teknik që jepet bashkëngjitur.

Gjithashtu në bashkërendim me fabrikën e prodhimit të autotransformatorit, SIEMENS ju dërgua i gjithë dokumentacioni i kërkuar dhe u plotësua formulari standard i kësaj kompanie për raste avarie në auto dhe transformatorë, që gjithashtu ju dërguan.

Nga ana jonë dhe nga ana e fabrikës është arritur në të njëjtin konkluzion:

Kemi dëmtim të bobinës kryesore të anës 400 kV por konkluzioni përfundimtar do të arrihet vetëm me hapjen e plotë në një fabrikë të specializuar.

Për sa më sipër konsiderohet si e domosdoshme:

- Furnizim vendosje e 1 faze tw Autotransformatorit 400/220 kV 115 MVA;
- Për kthimin në gjendje pune të Fazes A dhe të vetë AT-3x115 MVA, 410/230 kV është riparimi i tij në një fabrikë të specializuar. Theksojmë se të gjithë aksesorët e Fazës A të dëmtuar, izolatorët kalimtarë, kazani kryesor, sitemi i monitorimit, sistemi i ftohjes, qarku magnetik, rregullatori i tensionit, etj. Janë në gjëndje të mirë teknike;.

PROJEKTET E INVESTIMEVE PËR ZHVILLIMIN E OPERIMIT TË SISTEMIT

Projektet e nevojshme për sa i përket Zhvillimit të Operimit të Sistemit, të parashikuar për t'u realizuar gjatë periudhës 2025-2027, paraqiten më poshtë

SOFTWARE PER ANALIZEN E SISTEMIT

Operatori i sistemit te transmetimit ka përgjegjësinë e planifikimit afatshkurtër/afatgjate te rrjetit dhe gjithashtu planifikimin e sigurisë operationale te rrjetit te transmetimit.

Softet për analizën e sistemit ofrojnë një grup të plotë funksionesh për studimin e sistemeve të mëdha të ndërlidhura të energjisë dhe adresimin e këtyre nevojave te zhvillimit te Sistemit Elektroenergjetik. Softet e analizës se SEE përdoren gjithashtu për parashikimin e gjendjes se rrjetit për D2CF/DACF/IDCF (planifikimi IntraDay, planifikimi 1 dite ne avance dhe planifikimi 2 dite ne avance) gjithashtu dhe planifikimin e ndërprerjeve te elementëve te rrjetit. Në këtë kontekst kërkohet blerja e një softi i cili te këtë funksionet e mëposhtme:

- Aftësi të modelimit të sistemit të transmetimit.
- Analiza e shpërndarjes se flukseve dhe lidhjeve te shkurtra
- Librari për elementet e rrjetit dhe integrim i thjeshte i tyre ne diagrame.

- Modelimi i rrjetit të transmetimit në bus-branch (zbara dhe linja) dhe node-breaker (nyje, thika dhe çelësa).
- Integrimi i modelit, analizës dhe raportimit të rrjetit.
- Analize e sigurisë sipas një liste të paracaktuar kontigjencash.
- Menaxhimi i ndërprerjeve (remonte të pa/planifikuara)
- Llogaritje kapacitetesh (përfshirë dhe PTDF – llogaritje e kapaciteteve në përputhje me rregullat e reja të ENTSO-e.
- Analiza e harmonikave në sistemin e transmetimit dhe analize cilësie
- Angazhimi i Njësisë dhe Optimizimi i Dispečimit.
- Llogaritjet e kurbës PV/QV.
- Shpërndarja optimale e flukseve
- Analiza dinamike e sistemit të transmetimit bazuar në llogaritjet klasike ose në rrjetat neutrale për një përgjigje sa më të shpejte.

SOFTWARE PËR PARASHIKIMIN DHE DIMENSIONIMIN E REZERVAVE DHE SHËRBIMEVE NDIHMËSE

Operatori i Sistemit të Transmetimit, siguron shërbimet ndihmëse për balancimin e Sistemit Elektroenergetik në kohë reale. Sigurimi i shërbimeve ndihmëse paraprihet nga një proces parashikimi i kërkesave të sistemit për rezerva operative, si rezerva e mbajtjes së frekuencës, rezerva e restaurimit të frekuencës dhe rezerva zëvendësuese. Për secilën nga rezervat ka metoda deterministike ose propabilistike për parashikimin e vëllimit të tyre. Por këto metoda nuk marrin në konsideratë, zhvillimin e burimeve të rinovueshme dhe sfidat e reja që po përballon sistemi i Transmetimit të Shqipërisë.

Vitet e fundit vihet re një rritje e konsiderueshme e burimeve të reja gjeneruese dhe aplikimeve të mëtejshme për lidhjen e burimeve të reja. Në këtë kontekst është e nevojshme të aplikohen metoda të reja të dimensionimit dhe parashikimit të rezervave për qëllime të balancimit të SEE. Për këtë qëllim kërkohet sigurimi i një softi i cili duhet të plotësojë këto kërkesa:

- Mbajtjen e bazës me të dhëna mbi devijimet e SEE;
- Parashikimi i vëllimit të imbalancave në SEE dhe parashikimi i nevojës për rezerva automatike dhe manuale, bazuar në një algoritëm parashikues.
- Algoritmi mund të përdorë teknika të ndryshme për parashikimin e vëllimit të rezervave, si “Machine Learning” ose “rrjeta neurale”.
- Softi parashikues duhet të japë rezultate për afate të ndryshme kohore si dita në vance, java në avance, muaji deri në 1 vit.
- Të dhënat që mund të përdorë si “inpute” për parashikimin mund të jënë: ngarkesa, gjenerimi, devijimet e SEE, statistika të pritshme të incidenteve në SEE, si dalja jashtë pune e një njësie gjeneruese;

SISTEMI PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE TË OPERIMIT TË SISTEMIT

OST sh.a. disponon disa sisteme të teknologjisë së informacionit, nga të cilat përftohen të dhëna si energjia aktive, energjia reaktive, tensioni, frekuenca, skedulet e energjisë për çdo pjesëmarrës tregu, programi kompensimit, skeduli interkoneksionit etj. Këto të dhëna përftohen nga sistemi i matjes online dhe sistemi Novita. Volumi i të dhënave është mjaft i madh dhe përpunimi i tyre deri më tani realizohet në softin Excel të paketës Microsoft. Përpunimi i të dhënave me softin krijon një vështirësi të madhe dhe njëkohësisht është burim i gabimit në përpunimin e tyre. Rrjedhimisht për të rritur cilësinë

e përpunimit të dhënave dhe lehtësuar punën e specialisteve të sektorit të planifikimit të operimit, është e nevojshme të sigurohet një sistem IT i cili të ndërfaqesoje me sistemet ekzistuese.

Sistemi i ri i përpunimit të dhënave dhe raportimit duhet këtë këto karakteristika kryesore:

- Ndërfaqësimin me Sistemin e Matjes të Energjisë (SME) dhe Sistemin Novita (SD)
- Përfitim të dhënave që disponojnë SME dhe SD në mënyrë automatike dhe në forme manuale (opsionale);
- Mundësinë e përpunimit të dhënave me funksione/operatore algjebrike etj;
- Raportim të dhënash në ndërfaqe grafike dhe funksione eksporti të dhënave në formate të ndryshme.

UPGRADE DHE MIREMBAJTJE E SISTEMIT SCADA/AGC TË QENDRËS EMERGJENTE TË KONTROLLIT

OST sh.a. në vitin 2018 ka implementuar sistemin Qendra Emergjente Kontrollit (QKE) SCADA/AGC nga prodhuesi Koncar (Prozanet 3.3). Ky sistem përfshin nënstationet 400/220kV, 11 nënstatione 110kV të OST sh.a, HEC-et kryesore si: Fierze, Koman, Vau Dejës, Banja, Moglice, Peshqesh, Fang si dhe disa konsumatorë të kualifikuar të lidhur në rrjetin e transmetimit.

Sistemi Qendrës Emergjente Kontrollit garanton vazhdimësinë e funksioneve të Qendrës Kryesore Kontrollit në një rast të dështimit katastrofik. Dështim katastrofik i sistemit të QKK (Qendrës Kryesore Kontrollit) do të quhet dëmtimi hardware/software në të dy linjat e gatishmërisë tek serverat SCADA/EMS/AGC, që nuk mund të riparohen në një kohë të shkurtër dhe të cilat mund të gjenerojnë një rrjet transmetimi të pa monitorueshëm. QKE dhe QKK në të njëjtën kohë (edhe kur nuk ka dështim në QKK) duhet të jenë në gjendje të kryejnë funksionet aktive SCADA/AGC në mënyrë të pavarur. Nga Standartet e ENTSO-E, OST duhet të përmbushen të gjitha politikat dhe një nga kërkesat kryesore të deklaruara në Politikën 5, Kapitulli B-Standarti 3 është vazhdimësia e Funksioneve të Dhomës së Kontrollit në rast të problemeve me infrastrukturën.

Gjithashtu në mënyrë që të ruajmë integritetin e sistemeve të cilat kemi në menaxhim dhe të mbajmë në efikasitet sistemet SCADA të cilat paraqesin një rëndësi të veçantë si dhe duke qenë se është klasifikuar si infrastrukturë kritike e informacionit me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.222 datë 26.04.2018, propozojmë përmirësimet e mëposhtme të sistemit.

OST sh.a duhet të marrë masa për të bërë të mundur përditësimin si nga pikëpamja e hardware dhe të software në mënyrë që të eliminohen dhe parandalohen situata emergjente të cilat çënojnë integritetin e sistemit dhe funksionimin normal të tij. Cdo sistem operimi ka një jetëgjatësi të mirë përcaktuar nga prodhuesi e cila shprehet në faqet zyrtare të prodhuesve respektiv. Fundi i ciklit të jetëgjatësisë së një sistemi operativ do të thotë pamundësi për përditësime të paketave specifike software apo asistencë teknike nga inxhinierët e prodhuesit të këtyre sistemeve në rastet e keq funksionimit të sistemit, nga ku pa mbështetjen e të cilëve nuk do të mund të garantohet jetëgjatësia dhe operimi i këtyre sistemeve të operimit duke krijuar edhe vulnerabilitete ndaj sulmeve kibernetike. Për sa i përket pajisjeve hardwerike (Server, storage, firewall) shumica e tyre janë jashtë mbulimit me suport të ofruar nga prodhuesit, e cila nënkupton që automatikisht do të ulet siguria e funksionimit të këtyre pajisjeve në rast dëmtimi, si dhe rrit kohën e zgjidhjes së problematikave të ndryshme.

Një faktor tejet i rëndësishëm i cili ndikon drejtpërdrejt në nevojën për përmirësim të këtij sistemi lidhet edhe me faktin se OST sh.a ka zhvilluar politika dhe rregulla të reja mbi tregjet e energjisë elektrike, gjë e cila kërkon mbështetjen teknologjike për të bërë të mundur realizimin e të gjithë proceseve dhe përmbushjen e të gjithë detyrimeve sipas rregullave në fuqi. OST sh.a duhet të marrë

masa për ofrimin e zgjidhjeve automatike dhe përshtatjen me të gjithë ndryshimet e vazhdueshme që pësojnë tregjet e energjisë. Përditësimet Hardware/Software garantojnë që këto funksionalitete të përmbushen duke ofruar zhvillime të mëtejshme nëpërmjet aplikimit të standardeve dhe mjeteve të reja në përputhje me nevojat që paraqiten.

UPGRADE HARDWARE-SOFTWARE I SISTEMIT TE KONTROLLIT TË NËNSTACIONIT 220 KV FIERZE

Ky projekt investimi, është rivendosur në programin e Investimeve për periudhën 2024-2027

Sistemi aktual, përgjegjës për monitorimin dhe kontrollin e nënstacionit Fierzë është implementuar në vitin 2013.

Duke marrë shkas nga problematikat e shumta të shfaqura gjatë viteve të kaluara në sistemin e kontrollit të nënstacionit 220 kV Fierzë është e domosdoshme të bëhet një Upgrade i plote (hardware-software) i sistemit të kontrollit të këtij nënstacioni. Sistemi aktual nuk jep garanci për operim normal nga ana e dispecerave lokale për këto arsye:

- Konsumimi i lartë i pajisjeve hardware që përbejnë këtë sistem për shkak të periudhës rreth 15 vjeçare të instalimit të tij.
- Nuk prodhohen më pjesë këmbimi për pajisjet integrale të këtij sistemi Kontroll-Monitorimi siç janë (Switche Optike, Karta LON për server..etj). Nuk prodhohen më as versione të softeve të instaluar në server.
- Versione shumë të vjetra të Windows-it, përkatësisht Windows 7 dhe Windows server 2008. Për këto sisteme Windows kompania Microsoft ka mbyllur çdo lloj update dhe suport. Duhet domosdoshmërisht të kalohet në versionet më të fundit të Windows.
- Versioni i Software SCADA duhet ngritur në përputhje me versionet e reja të Windows për të qenë kompatibel dhe mundësuar operim dhe mirëmbajtje normale të këtij sistemi kontroll-monitorues.
- Serverat e sistemit janë shumë të ngarkuar me procese pune dhe rendimenti është zvogëluar ndjeshëm duke çuar në vonesa të shfaqjes së të dhënave në monitorët e operimit apo në kryerjen me vonese të procesit të komandimit lokal nga nënstacioni apo të komandimit në distance nga Dispeceria Qendrore.
- për normalizimin e këtij sistemi kontrolli është e domosdoshme të bëhet upgrade i plote si për punimin normal nga ana e operatoreve lokale ashtu edhe për zgjerimin me trakte të reja të këtij nënstacioni në të ardhmen.

Këto sisteme nuk përmbushin as kriteret minimale për sigurinë kibernetike të sistemeve lokale kontroll-monitoruese (Cyber Security).

Gjendja e operimit të sistemit cilësohet jo e mirë dhe problematikat e shfaqura kanë prekur disponueshmërinë apo operimin korrekt të sistemit.

UPGRADE HARDWARE-SOFTWARE I SISTEMIT TE KONTROLLIT TË NËNSTACIONIT 220 KV VAU I DEJËS

Ky projekt investimi, është rivendosur në programin e Investimeve për periudhën 2024-2027.

Sistemi aktual, përgjegjës për monitorimin dhe kontrollin e nënstacionit Vau i Dejës është implementuar në vitet 2012-2013. Sistemi lokal i kontroll monitorimi i implementuar është Prozanet 3 version 3.2.8. Duke marrë shkas nga problematikat e shumta të shfaqura gjatë viteve të kaluara në sistemin e kontrollit të nënstacionit 220 kV Vau i Dejës është e domosdoshme të bëhet një Upgrade

i plote (hardware-software) i sistemit te kontrollit te ketij nenstacioni. Sistemi aktual nuk jep garanci per operim normal nga ana e dispecerave lokale per keto arsye:

- Konsumimi i larte i paisjeve hardware qe perbejne kete sistem per shkak te periudhes rreth 15 vjecare te instalimit te tij.
- Nuk prodhohen me pjese kembimi per pajisjet integrale te ketij sistemi Kontroll-Monitorimi siç janë (Switche Optike, Karta LON per server..etj). Nuk prodhohen me as versione te softeve te instaluara ne server.
- Versione shume te vjetra te Windows-it, perkatesisht Windows 7 dhe Windows server 2008. Per keto sisteme Windows kompania Microsoft ka mbyllur çdo lloj update dhe supporti. Duhet domosdoshmerisht te kalohet ne versionet me te fundit te Windows.
- Versioni i Software SCADA duhet ngritur ne perputhje me versionet e reja te Windows per te qene kompatibel dhe mundesuar operim dhe mirembajtje normale te ketij sistemi kontroll-monitorues.
- Serverat e sistemit janë shume te ngarkuar me procese pune dhe rendimenti eshte zvogeluar ndjeshem duke çuar ne vonesa te shfaqjes se te dhënave ne monitorët e operimit apo ne kryerjen me vonese te procesit te komandimit lokal nga nenstacioni apo te komandimit ne distance nga Dispeceria Qendrore.
- per normalizimin e ketij sistemi kontrolli eshte e domosdoshme te behet upgrade i plote si per punimin normal nga ana e operatoreve lokale ashtu edhe per zgjerimin me trakte te reja te ketij nenstacioni ne te ardhmen.

Keto sisteme nuk permbushin as kriteret minimale per sigurine kibernetike te sistemeve lokale kontroll-monitoruese (Cyber Security). Gjendja e operimit te sistemit cilësohet jo e mire dhe problematikat e shfaqura kanë prekur disponueshemrine apo operimin korrekt te sistemit. Gjendja e operimit te sistemit cilësohet jo e mire dhe problematikat e shfaqura kanë prekur disponueshemrine apo operimin korrekt te sistemit.

UPGRADE HARDWARE-SOFTWARE I SISTEMIT TE KONTROLLIT TE NENSTACIONIT 400 KV KOMAN

Ky projekt investimi, eshte rivendosur ne programin e Investimeve per periudhen 2024-2027.

Sistemi aktual, pergjegjes per monitorimin dhe kontrollin e nenstacionit Koman eshte implementuar ne vitin 2012. Sistemi lokal i kontroll monitorimi i implementuar eshte Prozanet 3 version 3.2.8. Duke qene se te dhënat e ketij sistemi janë te perfshira (shërbejne si input) dhe ne logjiken LFC te HEC Koman ky sistem konsiderohet shume i rendesishem. Gjendja e operimit te sistemit cilësohet si jo e mire pasi pajisjet hardware mbi te cilat eshte implementuar sistemi I kontroll monitorimit janë te vjetra(out dated) dhe kanë ndikuar ne redudrancën e sistemit lokal te aplikuar ne kete nenstacion. Sistemi aktual nuk jep garanci per operim normal nga ana e dispecerave lokale per keto arsye:

- Konsumimi i larte i paisjeve hardware qe perbejne kete sistem per shkak te periudhes rreth 15 vjecare te instalimit te tij.
- Nuk prodhohen me pjese kembimi per pajisjet integrale te ketij sistemi Kontroll-Monitorimi siç janë (Switche Optike, Karta LON per server..etj). Nuk prodhohen me as versione te softeve te instaluara ne server.

- Versione shumë të vjetra të Windows-it, përkatësisht Windows 7 dhe Windows server 2008. Për këto sisteme Windows kompania Microsoft ka mbyllur çdo lloj update dhe supporti. Duhet domosdoshmërisht të kalohet në versionet më të fundit të Windows.
- Versioni i Software SCADA duhet ngritur në përputhje me versionet e reja të Windows për të qene kompatibel dhe mundësuar operim dhe mirëmbajtje normale të këtij sistemi kontroll-monitorues.
- Serverat e sistemit janë shume të ngarkuar me procese pune dhe rendimenti është zvogëluar ndjeshëm duke çuar në vonesa të shfaqjes së të dhënave në monitoret e operimit apo në kryerjen me vonese të procesit të komandimit lokal nga nënstacioni apo të komandimit në distance nga Dispeceria Qendrore.
- Për normalizimin e këtij sistemi kontrolli është domosdoshme të bëhet upgrade i plotë si për punimin normal nga ana e operatoreve lokale ashtu edhe për zgjerimin me trakte të reja të këtij nënstacioni në të ardhmen.

Këto sisteme nuk përmbushin as kriteret minimale për sigurinë kibernetike të sistemeve lokale kontroll-monitoruese (Cyber Security). Gjendja e operimit të sistemit cilësohet jo e mirë dhe problematikat e shfaqura kanë prekur disponueshmërinë apo operimin korrekt të sistemit.

UPGRADE HARDWARE-SOFTWARE I SISTEMIT TË KONTROLLIT TË NËNSTACIONIT 220 KV KOPLIK

Ky projekt investimi, është rivendosur në programin e Investimeve për periudhën 2024-2027.

Sistemi aktual, përgjegjës për monitorimin dhe kontrollin e nënstacionit Koplik është implementuar në vitin 2008. Sistemi lokal i kontroll monitorimi i implementuar është Microscada version 5. Duke qënë se të dhënat e këtij sistemi janë të përfshira (shërbejnë si input) dhe në logjikën LFC të HEC Koman ky sistem konsiderohet shumë i rëndësishëm. Gjendja e operimit të sistemit cilësohet si jo e mirë pasi pajisjet hardware mbi të cilat është implementuar sistemi i kontroll monitorimit janë të vjetra(out dated) dhe kanë ndikuar në redudrancën e sistemit lokal të aplikuar në këtë nënstacion. Sistemi aktual nuk jep garanci për operim normal nga ana e dispecerave lokale për këto arsye:

- Konsumimi i lartë i paisjeve hardware që përbëjnë këtë sistem për shkak të periudhës rreth 15 vjeçare të instalimit të tij.
- Nuk prodhohen më pjesë këmbimi për pajisjet integrale të këtij sistemi Kontroll-Monitorimi siç janë (Switche Optike, Karta LON për server..etj). Nuk prodhohen më as versione të softeve të instaluar në server.
- Versione shumë të vjetra të Windows-it, përkatësisht Windows 7 dhe Windows server 2008. Për këto sisteme Windows kompania Microsoft ka mbyllur çdo lloj update dhe supporti. Duhet domosdoshmërisht të kalohet në versionet më të fundit të Windows.
- Versioni i Software SCADA duhet ngritur në përputhje me versionet e reja të Windows për të qene kompatibel dhe mundësuar operim dhe mirëmbajtje normale të këtij sistemi kontroll-monitorues.
- Serverat e sistemit janë shume të ngarkuar me procese pune dhe rendimenti është zvogëluar ndjeshëm duke çuar në vonesa të shfaqjes së të dhënave në monitoret e operimit apo në kryerjen me vonese të procesit të komandimit lokal nga nënstacioni apo të komandimit në distance nga Dispeceria Qendrore.

- për normalizimin e këtij sistemi kontrolli është e domosdoshme të bëhet upgrade i plotë si për punimin normal nga ana e operatorëve lokale ashtu edhe për zgjerimin me trakte të reja të këtij nënstacioni në të ardhmen.

Këto sisteme nuk përmbushin as kriteret minimale për sigurinë kibernetike të sistemeve lokale kontroll-monitoruese (Cyber Security). Gjendja e operimit të sistemit cilësohet jo e mirë dhe problematikat e shfaqura kanë prekur disponueshmërinë apo operimin korrekt të sistemit.

PROJEKTET E INVESTIMEVE - PËR ZHVILLIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË DHE INFORMACIONIT, TELEKOMUNIKACIONIT DHE CYBER SECURITY

Projektet e nevojshme për sa i përket Zhvillimit të sistemeve të Teknologjisë dhe Informacionit, telekomunikacionit dhe Cyber security të parashikuar për t'u realizuar gjatë periudhës 2024-2027, paraqiten më poshtë

IMPLEMENTIMI I UPGRADE, ZGJERIMIT I SISTEMIT BACKUP DHE ZGJERIMI I PLATFORMAVE QENDRORE TI

OST, nëpërmjet teknologjisë së informacionit ka informatizuar dhe automatizuar një pjesë të madhe të proceseve të punës. Platformat dhe sistemet TI janë pike kyçe dhe kryesore për mbarrëvajtjen e punëve dhe kryerjen e detyrave funksionale. Për të optimizuar mënyrën e menaxhimit të sistemeve informatike në platforma tërësisht të sigurta për garantimin dhe ruajtjen e disponueshmërisë të shërbimeve dhe të të dhënave gjithashtu objekti kryesor është ndërtimi i sistemeve backup jo vetëm për ruajtjen e të dhënave por garantimi i integritetit dhe besueshmërisë të tyre për sa i përket sulmeve keqdashëse të tipeve ransomware.

Qëllimi i projektit është krijimi i kushteve të standardeve "Business continuity". Për të arritur këtë, ky projekt i cili ka për qëllim të sigurojë që funksionet kritike të OST sh.a. ose do të vazhdojnë të funksionojnë pavarësisht incidenteve serioze ose dëmtimeve që mund të ndërpresin shërbimet ose do të rikthehen në gjendje operacionale brenda një periudhe të shkurtër.

Objektiv tjetër kryesor i këtij projekti, është rritja e disponueshmërinë të shërbimeve të sistemeve dhe aplikimeve të cilat janë pika kyçe të funksionimit të kompanisë, në çdo komponent të tij, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës mbi parimin e DRS dhe BC.

Në funksion të këtij objekti dhe qëllimi, shërbimet e kërkuara kanë si objekt edhe zgjerimet e nevojshme dhe ndryshimet përkatëse në infrastrukturën momentale. Pika tjetër kryesore e këtij projekti është përfundimi i përmirësimit dhe përditësimit të nevojshme në baze të kërkesave në rritje për resurse të infrastrukturës hardware, software dhe rrjetit TI si dhe i krijimi i një infrastrukture me disponueshmëri të lartë dhe garantim i mbrojtës nga sulmet kibernetike.

PËRFITIMET:

- Garantimi i funksionimit të infrastrukturës kompjuterike dhe platformave teknologjike në kushte normale dhe në kushte emergjence;
- Garantimi i fleksibilitetit të infrastrukturës fizike, server, storage, etj.;
- Minimizimi i probabilitetit të mosfunksionimit të sistemeve të informacionit nga faktorë të jashtëm;
- Disponueshmërinë e shërbimeve dhe rritjen e sigurisë së informacionit;

DRS SITE DHE ZGJERIMI I PLATFORMES TEKNOLOGJIKE TE SCADA

Aktualisht OST sh.a. ka përfunduar me sukses projekti i upgrade te sistemi SCADA. Te parashikuar ne këtë projekt ka qene dhe sistemi i backup te te dhënave. Backup kryhet ne makina server te veçanta por qe ndodhen ne te njëjtin vendodhje me sistemin SCADA primar.

Qëllimi i projektit është krijimi i kushteve e standarteve "Business continuity". Per te arritur këtë, ky projekt i cili ka për qëllim të sigurojë që funksionet kritike te OST sh.a. SCADA EMS do të vazhdojnë të funksionojnë pavarësisht incidenteve serioze ose dëmtimeve që mund të ndërpresin shërbimet ose do të rikthehen në gjendje operationale brenda një periudhe të shkurtër.

Objektiv tjetër kryesor i këtij projekti, është rritja e disponueshmërinë se platformës ne çdo komponent te tij, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë se punës mbi parimin e DRS dhe BC.

PËRFITIMET:

- Garantimi i funksionimit te infrastrukturës OT ne kushte normale dhe ne kushte emergjence;
- Dublikimi dhe garantimi i fleksibilitetit te infrastrukturës fizike, server, storage, etj.;
- Minimizimi i probabilitetit të mosfunksionimit të sistemeve të informacionit nga faktorë të jashtëm;
- Disponueshmeria e shërbimeve dhe rritjen e sigurisë së informacionit;

ZGJERIMI I SISTEMIT TE SIGURISE PER PLATFORMAT OT

Operatori i Sistemit të Transmetimit si përgjegjës për rrjetin e transmetimin e energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë dhe kryerjen e funksioneve dhe operimin e sistemit ka te instaluar disa nga platformat teknologjike dhe sistemet informatike industriale më të rëndësishme dhe kritike nga pikëpamja e rëndësisë ne nivel kombetar.

OST në përputhje me kërkesat e ENTSO-E, ka instaluar dhe ne operim sistemi SCADA/EMS nga i cili monitorohen dhe operohen në kohë reale të gjitha stacionet 220/400 kV dhe stacionet më të rëndësishme 110 kV. Komunikimi i Sistemit SCADA/EMS me sistemet e SCADA lokale, te vendosura ne nenstacione, kryhet nepermjet rrjetit me fiber optike te OST sh.a. (infrastruktura e telekomunikacionit), si dhe me linjat e interkoneksionit që janë të ndërlidhura me vendet fqinje. Ekzistojnë tri lidhje komunikimi midis OST dhe vendeve fqinje, por dhe lidhje te tjera me kompani ne vend, si KESH, OSHEE, dhe gjenerues privat, etj.

Teknologjia e perdorur per transmetimit e te dhenave ne rrjetin me FO eshte e tipit SDH. Kjo teknologji megjithëse e vjetër është robuste dhe e qëndrueshme per sa i përket disponueshmerise, por ka nje disavantazh te madh per sa i perket sigurise te informacionit dhe kibernetike, segmentimit te rrjetit dhe sigurisë te te dhënave pasi ka ne fokus vetëm transmetimit e te dhënave.

Sa me siper, bazuar ne arkitekturen e rrjetit, topologjinë e lidhjeve dhe mënyrën e komunikimit ku gjenerues privat kane vizibilitet te rrjetit (te te gjithë ring) bazuar ne piken e lidhjes, ne sistemet OT (kryesisht SCADA) dhe lidhjet me operatore te tjere si KOSTT, KESH dhe OSHEE jane te pa monitoruara apo te mbrojtura, është e domosdoshme zgjerimi i perimetrit te sigurisë, segmentimi i rrjetit dhe enkriptimi i te dhenave.

OST ka kryer nje Vlerësim te përgjithshëm te sigurisë kibernetike dhe infrastruktures se shërbimeve OT/IT nga një grup kompanish te specializuara për sa i përket sigurisë kibernetike te infrastrukturave kritike dhe atyre ne OT. Një nga gjetjet kryesore dhe ku kërkohet te kryhen permisime është dhe sigurimi i perimetrit ne rrjetin OT ne Aparat Qendror dhe nenstacione.

Me ane te ketij projekti arrihet duke vendosur jo vetëm pajisje sigurie rrjeti ne pikat e kerkuara te perimetrit por duke implementuar zgjidhje te cilat na japin një qasje proaktive te manaxhimit te sigurte te rrjetit me ane te zgjidhjeve per menaxhimin e politikave te sigurise, automatizimin te tyre

dhe analizimit të të gjithë informacionit që lëviz të rrjetit dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet apo sulmet e dëmshme kibernetike.

PËRFITIMET:

- Menaxhimi i infrastrukturës kryhet nga një konsolë e vetme në mënyrë të centralizuar, të sigurojë vizibilitet të gjithë infrastrukturës dhe raporte të detajuara për gjendjen e rrjetit dhe pajisjeve.
- Automatizimin i proceseve të monitorimit dhe analize në mënyrë efektive të dhënave e regjistrave nga të gjitha asetet dixhitale në një vend.
- Kjo do të mundësojë operacione të ndryshme sigurie, identifikim proaktiv të rreziqeve dhe korrigjim të anomalive.

ZGJERIM I SISTEMIT TË ACCESS CONTROL NE NJESI OPERATIVE DHE NËNSTACIONET E OST SH.A.

Aktualisht sistemi i aksesit elektronik për punonjësit dhe vizitorët është i implementuar vetëm në zyrat qendrore të OST sh.a. Nevojitet shtimi i sistemeve të aksesit edhe për njësitë e tjera operative në mënyrë që të mundësohet një monitorim me i mirë dhe efikas për hyrje daljet e punonjësve të OST sh.a. apo vizitoreve të ndryshëm që mund të kërkojnë akses në zyrat e OST sh.a., njësitë operative, etj.

UPGRADE DHE ZGJERIMI I PLATFORMES SE MATJES ONLINE

Sistemi i matjes Online është një nga sistemet kryesore dhe kritik në OST sh.a. për këto arsye dhe për të garantuar disponueshmërinë e këtij shërbimi është e nevojshme që të kryhen upgrade të nevojshëm të platformës, kryerjen e pagesës së licencave dhe dhe Support për platformën e Matjeve Online dhe programet ndihmëse si ai Backup, etj.

Gjithashtu propozohet zhvillimi në gjerimin e raporteve të të dhënave dhe bilancit të energjisë elektrike, sipas kërkesave të drejtorive të OST sh.a. dhe institucioneve të tjera si KESH, OSSHE

UPGRADE I AMBJENTIVEVE TEKNOLOGJIKE, SCADA DHE MATJES ONLINE NE OST SH.A.

Dhoma e serverave janë pikat më të rëndësishme në Aparat Qendror dhe të sistemit informatik sepse përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është shumë më i lartë se në ambientet e tjera të punës. Në këtë ambient janë të vendosura sisteme të një rëndësie të veçantë në nivel kombëtar.

te tilla si SCADA, Matja Online dhe Sistemet qendrore T.I. si dhe në disa njësi operative nuk përmbushin kërkesat e kërkuara të sigurisë fizike, teknologjike dhe parametrave teknike. Nevojitet ndërhyrje në këto dhoma në mënyrë që të rritet niveli i sigurisë së tyre si dhe të krijohen kushte ambientale të përshtatshme për funksionimin e pajisjeve teknike që ndodhen në to duke implementuar sisteme monitorimi, sisteme ftohje profesionale për datacenter dhe garantimi i furnizimit me energji elektrike.

PËRFITIMET: Objektivi dhe përfitimet nga ky projekt janë:

- Standardizimi, menaxhimi dhe mirëmbajtja e dhomës së serverëve. Garantimi i funksionimit të infrastrukturës kompjuterike në kushte normale dhe në kushte emergjence;
- Garantimi i fleksibilitetit të infrastrukturës fizike;
- Minimizimi i probabilitetit të mosfunksionimit të sistemeve të informacionit nga faktorë të jashtëm;
- Rritja e sigurisë së informacionit.

UPGRADE I PAJISJEVE TË INXHINIERIMIT PËR SISTEMIN SCADA

OST sh.a. ka përfunduar me sukses projektin e upgrade të sistemit SCADA. Aktualisht pajisjet end point dhe makinat e inxhinierimit janë prej disa vitesh në operim. Me qëllim rinovimit dhe zgjerimit të kapaciteteve të këtyre workstaion në Aparat Qendror por dhe në sallat e komandave në nënstacione për të krijuar kushte më të mira për kryerjen e operimit të sigurtë dhe me cilësi të

sistemeve te automatizuara dhe për përmbushjen e detyrave funksionale. Si dhe për t'u përshtatur sa më mirë me rekomandimet e vendor ABB dhe zhvillimet teknologjike është e nevojshme pajisja me makina workstation te reja.

PËRFITIMET:

- Rritja e produktivitetit dhe përshtatja me zhvillimet e reja teknologjike.

UPGRADE, MIRËMBAJTJE DHE ZGJERIM I SISTEMIT MONITORIMIT TE PERIMETRIT DHE CCTV DHE SIGURISË SË PERIMETRI NË NËNSTACIONET E OST SH.A.

Aktualisht pranë OST sh.a janë të instaluara sisteme CCTV vetëm në nënstacionet si më poshtë:

- Nënstacioni 400 kV Zemblak
- Nënstacioni 400 kV Elbasan 2
- Nënstacioni 220 kV Tirana 1
- Nënstacioni 400 kV Tirana 2
- Nënstacioni 220 kV Fier

si dhe sistem për perimetër sigurie në nënstacionet si më poshtë :

- Nënstacioni 400 kV Zemblak
- Nënstacioni 400 kV Elbasan 2
- Nënstacioni 400 kV Tirana 2

Operatori i Sistemit të Trasmetimit si pjesë e infrastrukturave kritike ka të nevojshme rritjen e sigurisë fizike pranë nënstacioneve të tensionit të larte.

Bazuar në udhëzimin e Ministrise se Puneve te Brendshme Nr. 134 date 10.03.2017 sipas nenit 19 te këtij ligji pika 2/8 mbi nevojën për monitorimin dhe mbrojtjen e nënstacioneve dhe zyrave ne pronësi apo përdorim të OST sh.a. nevojitet të zgjerohet dhe instalohet edhe në nënstacione të tjera, sistem kamerash, sistem sigurie perimetrale dhe sisteme komunikimi të zyrave midis tyre. Ky investim do të kryhet në disa zyra dhe nënstacione të OST sh.a.

ZGJERIMI I KAPACITETEVE DATA DHE SHITIMI I PIKAVE TE REJA TE AKSESIT NE RRJETIN KOMERCJAL

Propozimi për zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit të OST sh.a për të plotësuar kërkesat e kapaciteteve transmetuese dhe për të rritur prezencën e rrjetit në stacione energjetike është një hap i mire për të optimizuar shfrytëzimin e burimeve dhe për të krijuar burime të reja të ardhurash. Ky investim ka potencialin të sjellë shumë avantazhe, siç janë:

Mirëmbajtja e Sistemeve Energjetike: Zgjerimi i rrjetit do të ndihmojë në monitorimin dhe kontrollin më të mirë të sistemeve energjetike. Kjo është e rëndësishme për të siguruar që sistemi funksionon në mënyre efikase dhe të parandalohen ndalesat e panevojshme.

Kapacitete Transmetuese të Shtuara: Investimi do të ofrojë kapacitete transmetuese shtesë, që mund të shfrytëzohen për të transferuar energji dhe të komunikojnë me stacione energjetike të tjera. Ky aspekt do të ndihmojë në optimizimin e operacioneve dhe shfrytëzimin e burimeve.

Burime të Ardhurash: Pjesa e rrjetit që do të përdoret për qellime komerciale mund të krijojë burime të reja të ardhurash per OST sh.a. Ky investim do të mundësoje që OST të ofrojë shërbime komunikimi të shpejta dhe të sigurta për palë të tjera jashtë kompanisë, duke krijuar një burim të ardhurash te qëndrueshme.

Zhvillimi Teknologjik: Investimi në modernizim do të ndihmojë në zhvillimin e teknologjive të sistemeve energjetike dhe të komunikimit. Kjo mund të ndikojë pozitivisht në efikasitetin dhe sigurinë e operacioneve.

Kontrolli dhe Siguria: Me një rrjet të zgjeruar dhe të modernizuar, OST sh.a do të ketë më shumë kontroll mbi sistemin energjetik dhe të komunikimit. Siguria do të jetë një aspekt i rëndësishëm për të parandaluar incidente dhe shpërndarje të informacionit.

Ne përgjithësi, ky investim duket të ketë potencialin të sjellë avantazhe të rëndësishme për OST sh.a, si dhe për sistemet energjetike dhe palë të tjera të interesuara.

D. Projektet e Investimeve me fondet e Huaja për periudhën rregullatore 2022-2024

Në mënyrë të detajuar, realizimi i investimeve për këtë periudhë paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Pershkrimi	2025	2026	2027
1	Eficienta energjetike programi per sektorin e enegjise elektrike	1,186,427,748	0	0
2	Linja 400 kV Shqiperi - Maqedoni Tranche I & Tranche II	3,117,431,762	0	0
Totali		4,303,859,510	0	0